

The electronic version of the book
is created by

<http://www.enverhoxha.ru>

for

<http://www.enverhoxha.info>

SHEFQET PEÇI



*Komandant,
na dogji malli*

(KUJTIME)

SHEFQET PEÇI

*Komandant,
na dogji malli*

(KUJTIME)

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

Redaktor: *Spiro Dede*
Recensues: *Sevo Tarifa*

DY FJALË LEXUESIT

Nuk më kishte shkuar kurrë ndër mend se do të vinte një ditë që me vullnetin tim do t'i jepja këto copëza kujtimesh për botim e t'i shihja të shtypura edhe në libër. Ca më pak akoma se do t'i shoqëroja edhe me një tufë elegjish, ku qaj me lot për atë që për shtat i ka shkuar e do t'i shkojë vetëm kënga e himni.

E kisha nisur e menduar fare ndryshe punën e ketyre kujtimeve.

Vite më parë fillova të hedh në letër mbresa e përshtypje nga kontaktet dhe marrëdhëniet e mia me të shtrenjtin shokun Enver, pa pretenduar të bëja regjistrimin e plotë e

me hollësi të tyre dhe pa synuar që t'i përmbledhja e t'i sistemoja në ndonjë libër.

Fati im i madh, ashtu si i shumë e shumë të tjerëve, ka qenë se që nga dita kur e njoha Komandantin, për herë të parë nga afër në Përmet, në maj të 1944-ës e për 40 vjet me rradhë, jam takuar me të shumë shpesh, e kam dëgjuar fjalën e mendimin e tij të shquar në qindra mbledhje e takime pune; i kam ndier forcën dhe zemrën e tij të ndritur prej mësuësi, udhëheqësi e shoku të rrallë në kaq e kaq raste e situata. Kuptohet, të shkruaja kujtimet e mbresat e mia nga të tëra këto veprimtari e takime, jo vetëm do të duheshin vëllime të tëra, por për mua kjo do të qe e pamundur. Më mirë e më saktë se çdo kujtim, për veprimtarinë e madhe, kolosale të shokut Enver, flet vetë Vepra e tij. Ndaj për kujtimet e mia, që në fillim, u nisa nga mendimi që të shënoja kryesisht mbresa e përshtypje nga takimet e lira e të shpeshta që kam pasur me Komandantin në shtëpinë e Partisë, në shtëpinë e tij, në raste vizitash në rrethe, në pushimet midis mbledhjeve të ndryshme, kur më ka thirrur personalisht në zyrë për të më ngarkuar ndonjë detyrë, për të më ndihmuar etj. I shkruaja këto, si i thonë fjalës, për qejf e për mall, nga dashuria e respekti i thellë për mësuësin dhe udhëheqësin tonë të lavdishëm, për Komandantin tonë të paharruar. Sidomos kur qëllonte

që, për arsye pune e shërbimi, kalonin 20-30 ditë pa e parë e takuar nga afër shokun Enver, më mbulonin më shumë kujtimet dhe, në raste të tilla, hidhja edhe ndonjë gjë në letër.

Kisha vendosur, bile 3-4 vjet më parë kisha dhënë edhe porosi, që këtë tufë shënimesh, pas meje, t'ia jepnin si dhuratë e si kujtim vetë shokut Enver! Doja e ëndërroja që, kur të gjente kohë, të çmallej me ushtarin e me shokun e tij, Shefqet Peçin, që e donte aq shumë, që për Partinë e Komandantin ishte gati të linte kokën! Kështu ëndërroja dhe porosinë e kisha dhënë të prerë. Sepse çdo gjë mendoja e përfytyroja, por që do të rroja për të parë e për të qarë me lot atë 11 prill të 1985-s, këtë s'e kisha menduar kurrë! Por e keqja e madhe ndodhi dhe unë, si të gjithë, i jetova me lot në sy e me hidhërim të patreguar në zemër ditët e rënda të atij prilli, të atij maji, të atij viti.

Pastaj. . . bashkë me shokët, bashkë me popullin e me Partinë në ballë i vura krahët punës edhe unë. Kështu e donte dhe e do nderi i Enverit, Vepra dhe çështja e tij. Kështu e do çështja e Partisë dhe e popullit: grusht rreth Partisë e Komitetit të saj Qendror, krah e grusht rreth bashkëluftëtarit e bashkëpunëtorit besnik e të shquar të Enverit, shokut Ramiz Alia!

Në këto e sipër mbaja përpara, në mendje e në zemër, shënimet që kisha hedhur për Ko-

mandantin. Fijet e letrës më digjnin në duar; më dukej sikur më pyeste e më pyet, ashtu siç dinte të fliste ai: «E, Shefqet, si je?». Si përgjigje, vendosa t'i bëj publike këto shënime. E di se s'kam mundur të hedh as të njëmijtën e atyre që meritojnë të thuhet për të lavdishmin Enver Hoxha. E di se edhe të tjerë do të shkruajnë e do të shprehin mendimet e mbresat më të bukura për të, por unë, si më i moshuari, po e hedh i pari hapin.

A U T O R I

Prill 1986

Kujtime

Për herë të parë e pashë dhe e takova nga afër shokun Enver në Kongresin e Përmetit, më 20 maj 1944. Në këtë takim ai më pyeti gjerë e gjatë për luftimet e Brigadës V Sulmuese. I përgjigjesha, por mendja e sytë më mbetën te pamja e tij e hijshme që më bëri aq përshtypje, te thjeshtësia dhe interesimi gjer në imtësi që tregonte, pikërisht në ato kohë kur kishte aq shumë punë e halle, sepse merrej me përgatitjen e Kongresit që do të fillonte punimet pas 4 ditësh. Nuk është vendi këtu të shkruaj për kujtimet e mia nga ai Kongres i paharruar, kur populli luftëtar, me Partinë e Enver Hoxhën në krye themeloi Shqipërinë e re, populllore

e demokratike. Dua të përmend nga ato ditë vetëm një moment me shokun Enver.

Kishin përfunduar punimet e Kongresit dhe në një nga ato ditë e pashë shokun Enver tek po kalonte vetëm në qytetin e Përmetit, për të shkuar në zyrë. Iu afrova dhe ai më kapi për krahu.

— Shoku Enver, — i thashë, — duhet të ruheni, se në këto kohë ruhemi dhe ne, jo Ju!

Qeshi dhe filloi fjalë tjetër. Do të largoheshim nga Përmeti, prandaj ai na dha porosi për manovrimin e brigadës, për luftën, për ruajtjen e forcave me kujdes.

— Këtej e tutje lufta do të jetë më e ashpër! — tha. — Brigada V do të inkuadrohet në Divizionin I Sulmues, do të kaloni në luftime më të gjera e të fuqishme, ndoshta edhe tej kufijve...

Ishte fillimi i pranverës së vitit 1945, kur më erdhi urdhri dhe u ktheva në Shkodër si komandant i Korparmatës III. Në një nga ato ditë, mora në telefon Komandën e Përgjithshme, organizimin. Në telefon një zë i njohur:

— Jam Enveri!

U gëzova sa më s'ka, por dhe u impresionova. Më foli gjithë përzemërsi, më pyeti për shëndetin, për situatën në qarkun e Shkodrës, për gjendjen e forcave tona që luftonin përtej kufirit. Filloi të më pyesë dhe se ç'nevoja personale kisha.

— Desha ndonjë nga shokët e organizimit për disa makina për transportimin e partizanëve, — i thashë.

— Do t'jua them unë shokëve, —
m'u përgjigj shoku Enver.

Ashtu u bë...

S'vonoi shumë dhe mbas ca ditëve u zhvillua një mbledhje e Shtabit të Përgjithshëm në Tiranë ku u thirra edhe unë. Mbledhjen e drejtonte vetë Komandanti i Përgjithshëm, shoku Enver. Kur mbaroi mbledhja, më thirri pranë dhe më uroi që u emërova anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.

Pas ca kohësh, me organizimin e ri në ushtri, u caktova me detyrë në Komandën e Përgjithshme të Ushtrisë, në Tiranë.

Nuk kishte kaluar veçse pak kohë që ishte çliruar Shqipëria dhe shoku Enver e gjeti kohën të vejë e të takohet me nafi-tëtarët në Qytetin Stalin. Në këtë vizitë të parë e shoqëroja edhe unë. Qyteti ishte i shkatërruar nga lufta. Shkuam në central e në disa vende të tjera. Shoku Enver ecte me kujdes duke parë çdo gjë. Më thotë:

— Nafta është e vështirë për ta nxjerrë dhe ne s'kemi akoma eksperiencë, por duhet të bëjmë çmos për ta shtuar prodhimin. Po të marrim shumë naftë, do të kemi të ardhura për ekonominë dhe do t'i japim ushtrisë edhe më shumë. Por edhe ju duhet të ndihmoni në ndërtimin

e vendit. Mos mendoni vetëm për goditje e stërvitje. Këto po e po, do t'i shihni në radhë të parë, por ushtria jonë duhet të ndihmojë edhe ekonominë e shkatërruar nga armiku.

Dëgjoja me kujdes, por po të mos m'i thoshte shoku Enver këto gjëra, nuk do të isha dakord, se unë mendoja ndryshe, domethënë çdo gjë për ushtarin, dhe ushtria të mbetej në stërvitje si ushtri kazerme, vetëm për luftë! Vathë në vesh ato fjalë...

Në një mbrëmje gazmore (nuk më kujtohet shkaku), në vitin e parë pas Çlirimit, ishin mbledhur gjithë shokët e Komitetit Qendror, të Qeverisë e të Shtetit. Filluan të dansojnë. Shoku Enver po më vërente se si i shikoja unë shokët që dansonin, dhe më thotë:

— Shefqet, si të duket?

— Mirë, shoku Enver.

— Po pse nuk danson një herë! — më tha ai prapë.

— Kam preferuar më shumë vallen labçe, shoku Enver, — i thashë, — prandaj nuk dansoj mirë.

— Domethënë di të dansosh, gjersa thua se nuk di mirë!

Më zuri në fjalë. Hidhet një shok tjetër dhe i thotë:

— Kur ishim në shkollën ushtarake, përpara, mësonim të dansonim.

— Unë s'e besoj që Shefqeti të ketë dansuar, — tha shoku Enver duke qeshur. — Vetëm në qoftë se e kanë detyruar, nga e keqja, po!

— Ashtu është shoku Enver, — i thashë dhe ai ia shkrepiti të qeshurit.

Festën e Mallakastrës, në Poçem, e nderon me pjesëmarrjen e tij shoku Enver. Kanë ardhur dhe nga Kurveleshi. Shoku Enver shikon një lab të moshuar, qylafi përmbi sy, me gjerdan për mesi dhe me pushkë që s'e lëshonte nga dora. Me buzë në gaz më thotë:

— Nga ç'fshat i Kurveleshit është ky lab i moshuar, Shefqet?

— Nga Nivica, — them, — quhet Feim Sejdia.

— Shiko si është veshur, me rroba leshi, me gjerdan e dyfek dhe në tërë këtë vapë të madhe nuk ka gajle fare. Ç'ndryshim të madh ka nga të tjerët! Si ka mundësi, të jetë rritur në ato vende të

larta dhe e duron vapën i veshur kështu rëndë me rroba leshi?!

— U mësua, shoku Enver, — i them unë.

— Si u mësua? — më tha.

— Iku nga Kurveleshi dhe u bë fusharak, ka ardhur në Levan me familje.

— Domethënë ti je kundër që ka ikur nga Kurveleshi, — më tha shoku Enver.

— Të të them të drejtën, shoku Enver, kur ikin nga Kurveleshi, s'më vjen mirë fare.

Shoku Enver qeshi dhe më tha:

— Ashtu është, por Partia e pushteti duhet t'i krijojë kushte jetese më të mira kurveleshasit. Pastaj të shohësh ti, ikin a jo!

Unë s'foli më. Vetëm mendova...

Gjatë vizitës së parë pas Çlirimit që bëri në rrethin e Vlorës, shoku Enver shkoi me dekovil në Selenicë. Midis shumë shokëve të tjerë, e shoqëroja edhe unë.

Gjatë vizitës vjen një grua të anko-
het për diçka.

— Dëgjoje ti ç'ankesa ka, — më thotë Koçi Xoxja, dhe s'ia vuri veshin.

Shoku Enver, aty më këmbë, e vuri re këtë bisedë, sado që ishte duke biseduar me drejtorin e me të tjerë njerëz të minierës.

E dëgjova atë grua dhe u ktheva pastaj t'ia transmetoja ankesën Koçit. Ky ma bëri me dorë «lëre mos e nga», me

demek, si gjë të parëndësishme. Edhe këtë gjë e vuri re shoku Enver dhe, pasi mbaroi me drejtuesit e minierës, m'u drejtua mua në prani të të gjithëve:

— Ç'nevoja kishte ajo shoqja që ti e dëgjove?

— Çështje të vogël, shoku Enver! Ka ardhur nga fshati këtu për punë, por s'ka strehim.

— Për ne, — m'u kthye shoku Enver, — shoku Shefqet, kjo mund të jetë e vogël, por për atë është jetike. Ajo ka ikur nga fshati se, me siguri, i është djegur shtëpia, dhe kërkon fole të futë kokën. Prandaj halli i saj nuk është gjë e vogël, e duhet zgjidhur drejt. Aty për aty iu drejtua drejtorit të minierës:

— Ta rregulloni menjëherë!

E kuptova: vërejtja nuk ishte vetëm për mua, por për të gjithë ata që e shoqëronin.

Më ka mbetur në mendje ky episod përgjithmonë dhe sa herë kam të bëj me ankesat e popullit, më vien ndër mendje qëndrimi i shokut Enver. Kaluan vite dhe kur punoja në Komisionin e Kontrollit, shoku Enver më pyeti se si i shikonim ankesat e popullit. Iu përgjigja duke i treguar procedurën që ndiqnim ne me anën e Degës së Ankesave.

Pasi më dëgjoi, më porositi që ne të shikonim dhe në komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve se si zgjidhen atje ankesat e popullit, si pritet populli e më dha shumë porosi të tjera të vlefshme. Ai tregoi pastaj për disa ankesa që i qenë drejtuar atij dhe që njerëzit kishin hak. Tek i dëgjoja, sillja ndër mend mangësitë tona dhe më vinte turp e maraz që nuk kishim atë kujdes e shqetësim që kishte shoku Enver për popullin, për hallet e tij.

Nisi të zbatohet Reforma Agrare. Në Lushnjë Komandanti do të ndante tapitë e tokave. Nisem nga Tirana për të shkuar më përpara në vendin ku do të bëhej ceremonia e dhënies së tapive, por në rrugë, afër Shkumbinit, më prishet makina. S'kaloi shumë kur ç'të shoh: Shoku Enver po vinte pa makinë shoqëruese! Ndali me buzën në gaz dhe hipi në një majë aty afër, për të parë e njëkohësisht të më priste dhe mua sa të më rregullohej makina.

— Ke makinë të mirë, «Bujk», o Shefqet, — më thotë.

— Po, shoku Enver, të mirë e kam, por kërkojnë të ma marrin!

— Mos e jep! — më tha.

— Tani që më thatë Ju, nuk e jap! —
i thashë duke qeshur. — Vetëm urdhri
Juaj ma merr!

Dhe ai duke qeshur e përsëriti: —
Mos e jep!

Heshta ca e pastaj i them:

— Nuk më vjen mirë që udhëtoni pa
makinë shoqëruese! Lëri të tjerat, por një
makinë edhe mund të prishet udhës, siç
m'u prish mua! Ai buzëgaz më tha:

— Kjo s'është puna ime!

Më piku në zemër, se kujt t'ia thosha!
Ministër i Brendshëm në atë kohë ishte
Koçi Xoxe.

U nisëm dhe shkuam në vendin e ce-
remonisë ku do të ndaheshin tapitë. Po-
pull i madh. Na u desh gati gjysmë ore
që të dilnim në pazar, mbasi populli ishte
i panumëruar. Të gjithë donin të shikonin
shokun Enver.

Shkuam për të inauguruar rrugën e Lozhanit. Do të gdhëshim në Cërrik me shokun Enver e shumë shokë të tjerë.

Shkova më parë në dhomën ku do të flinte shoku Enver. U shqetësova se nuk kishte as pajisjet, as pamjen e duhur. S'më rrihej. Doja të ndreqej më mirë dhe po bëja fjalë me përgjegjësën. Shoku Enver vjen nga prapa, pa e parë unë (se dhomat s'kishin dritë) e më thotë:

— Ç'ke Shefqet?

Nuk desha t'i them gjë, por ai më kuptoi.

— Mos u shqetëso kot, një natë është. Harrove që kur ishim partizanë s'kishim as bukë ngandonjëherë, pa le krevat!

Unë akoma s'mund ta çelja fytyrën, aq isha vrenjtur e shqetësuar, kurse shoku Enver rrinte me gaz e përzemërsi. U çudita.

Të gjithë u çelëm, sidomos ata të Cërrikut. Mbase dhe ata kishin hak. Ishte koha e Çlirimit, fillimi.

Pasi punova pak kohë komandant i Divizionit V në Tiranë, aty nga qershori i vitit 1946 më thirri shoku Enver dhe më komunikoi:

— Do të shkoni komandant i Divizionit V në Gjirokastrë, se situata me monarko-fashistët grekë është acaruar.

Më foli goxha e më dha plot porosi, pastaj shtoi:

— Ju dërgojmë atje si komandant divizioni, jo se shoku që është tashti s'ka aftësi. Jo, në asnjë mënyrë, edhe ai është shumë i aftë! Por ju, si nga Gjirokastra që jeni, njiheni më shumë nga populli dhe vajtja juaj atje, pikërisht në këtë situatë. është e nevojshme.

Jam në Gjirokastër, komandant divizioni. Nga Shtabi i Përgjithshëm më lajmërojnë të nisem për në Tiranë, në raport të Komandanti i Përgjithshëm, shoku Enver. Na priti, siç priste ai, në zyrën e tij, me sa mbaj mend, në katin e parë të shtëpisë ku dhe banonte. Filloi të më pyesë për gjendjen e ushtrisë, për nevojat, për veshjen, për moralin, për situatën në qarkun e Gjirokastrës, për punën politike në ushtri etj. Me kujdes të madh doja të mos ia thosha të gjitha të metat, mbasi nuk doja ta shqetësoja. Ishte e natyrshme, në atë kohë ushtria jonë kishte shumë halle e telashe.

Por u habita: filloi t'i thoshte vetë një nga një të gjitha, sikur të ishte ai komandant i divizionit!

Jemi në mbledhjen e Kuvendit Popullor, miratohet dekreti mbi sekuestrimin e bagëtive të të pasurve. Në listën e armiqve të popullit, s'dij se si, kanë futur dhe N. B. nga Golemi, S. Ç. nga Gusmari dhe R. K. nga Picari. I njoh mirë këta njerëz. Të tre kanë qenë të vendosur për Luftën Nacionalçlirimtare dhe nuk kishin kursyer asgjë për Luftën!

Kur u bë pushimi, i revoltuar iu drejtova disa shokëve që ishin në komision dhe u thashë se nuk ishte aspak e drejtë që këta të tre të futen në listën e armiqve të popullit.

— Në qoftë se kanë mbi numrin që

duhet, — u thashë, — t'u merren, por në asnjë mënyrë të cilësohen si armiq!

Në këtë kohë nga mbrapa meje (unë nuk e shikoja) qëndronte shoku Enver. Më hodhi dorën në sup dhe më thotë:

— Ç'thoni, shoku Shefqet?

Ia shpjegova të gjitha ato që u thashë edhe shokëve të komisionit para se të vinte shoku Enver aty.

— Është e drejtë! — tha dhe tundi kokën.

Të nesërmen pashë në gazetë se që të tre ishin hequr nga lista si armiq të popullit. Ç'kujdes i madh e ç'vëmendje për çdo gjë!

Më 1947, aty nga muaji shtator-tetor shoku Enver erdhi për vizitë në Kuç dhe, në mes një grupi shokësh, dola dhe unë në kufi të Kallararit për ta pritur. S'kishte gëzim më të madh për popullin e Kurveleshit! Kur doli nga makina, m'u drejtua e më tha:

— Erdha dhe në Kurvelesh, o Shefqet Peçi!

Më mbuluan djersët nga gëzimi. Në Kuç u bë një pritje madhështore, si asnjëherë, nga tërë populli i Kurveleshit.

Nga Kurveleshi shkuam për në Gjirrokastër, ku, gjithashtu, iu bë një nga pritjet më të mëdha që kam parë.

Erdhi vizitoi dhe komandën e divi-

zionit në Grehot e, mes të tjerash, u fut në klubin e oficerëve. Tek pa rregullin dhe sidomos mobilitet e klubit, më tha duke qeshur:

— Ju mobiljet i paskeni më të mira nga tonat në Tiranë!

E ndjeva se ku qëllonte, por ç'të thosha!

Në Komitetin Qendror zhvillohej një mbledhje e kuadrove, ku shtrohej puna për forcimin e disiplinës në ushtri. Mbledhjen e drejtonte vetë shoku Enver, ishin dhe një pjesë e shokëve të Byrosë Politike. Isha përgatitur të flisja me forcë për disiplinën, sepse, e mbaj mend mirë, isha i pakënaqur që s'kishim një disiplinë të fortë, siç doja unë. Shoku Enver sikur m'i kapi e m'i kuptoi të gjitha qëllimet ndaj kur u ngrita, më tha:

— Mos u zgjat shumë, shoku Shefqet, se mungesat e disiplinës dihen! Ushtria jonë partizane tash sapo doli nga lufta, patjetër do të ketë mungesa discipline, të cilat Partia do t'i vërë në vend.

Në shtator të vitit 1948, kur kishte shpërthyer lufta e ashpër kundër revizionistëve titistë e agjentëve të tyre me Koçi Xoxen në krye, në një nga kinematë e Tiranës, zhvillonte punimet Aktivi i Partisë i Tiranës. Në pushim doja të piqesha me shokun Enver, por nuk gjeja radhë, sepse të gjithë donin ta takonin. Shoku Enver se nga më pa, ma bëri me kokë dhe iu afrova. Kisha muaj pa e parë, tërë muajt pas Plenumit famëkeq të shkurtit të atij viti, kur titistët dhe vegla e tyre, Koçi Xoxja, ishin përpjekur të hidhnin baltë mbi Partinë e mbi Komandantin dhe desh na bënë gjëmën. Kur më takoi shoku Enver, nuk më tha asnjë fjalë, vetëm më

shtrëngoi dorën fort. Ai shtrëngim, dore në ato kohë sikur më dha të gjitha të mirat e gëzimet që më mungonin. Më dha dritë. Mora energji të reja edhe për një luftë tjetër!

Në Kongresin e Parë të Partisë, kur mbaruam zgjedhjet e Komitetit Qendror, isha ndërmjet shokëve që uronin për suksesin e madh të Partisë. Dolëm triumfues nga tërë ato luftëra e prapaskena tradhtie të revizionistëve titistë në bashkëpunim me Koçi Xoxen me shokë. Shoku Enver me buzëqeshje afrohet e më thotë:

— E, Shefqet Peçi, e shpëtua Partinë nga armiqtë! Tani jemi më të fortë!

— Me Ju në krye, shoku Enver! — i thashë shumë i emocionuar.

— Partia, Partia të rrojë, — vazhdoi shoku Enver, — Koçi Xoxes s'i japim as majën e thoit me vete! Ata që kanë ga-

buar në rrethana të ngushta, Partia do t'i ndihmojë dhe do t'i shpëtojë!

Dhe ashtu veproi Partia, siç tha largpamësi e shpëtimtari i saj, shoku Enver.

Viti 1948, dhjetor. Shoku Enver, pasi mori pjesë në analizat që u bënë në Vlorë për zbërthimin e materialeve të Kongresit të Parë të Partisë, do të nisej për në Kuçovë. Do ta shoqëroja edhe unë deri në Berat. Një nga shokët, i cili do të nisej në drejtim tjetër, më thotë:

— T'i themi shokut Enver që S. S. të ripranohet në Parti.

— Thuaja ti, — iu përgjigja. — Unë, e shumta që mund të bëj, është të të mbështes po më kërkoi mendim shoku Enver.

Gjetëm momentin e ia thamë. Shoku Enver na dëgjoi, pastaj i revoltuar na u Përgjigj:

— S. S., si «luftëtar i shquar», siç e

cilësoni ju, dhe pjesëtar i Luftës Nacionalçlirimtare, mund t'ju shkojë në mend ta bëni edhe gjeneral, por anëtar partie në asnjë mënyrë jo! Ai është me mendime tepër prapanike e të mykura, të cilat i ka demonstruar hapur. S'është ky komunisti!

Mora një mësim' të mirë atë ditë, veçanërisht për cilësitë e komunistit: Ai duhet të jetë i pastër, i kulluar nga të gjitha anët, e jo vetëm trim apo ushtarak i zoti.

Shkuam në Berat. Konferenca aty i vazhdoi punimet 4 ditë. Para pak kohësh isha rrëzuar dhe kisha thyer dy brinjë, por shokut Enver nuk i kisha thënë gjë, sepse ai do të më kthente në Tiranë, ndërsa unë doja të rrija sa më shumë afër tij për të mësuar sa më shumë. Natën vonë dëgjova në radio se u çlirua Pekini. Në mëngjes, kur u ngrit shoku Enver i thashë për çlirimin e Pekinit dhe e kuptova se e kishte dëgjuar vetë. Me buzë në gaz më tha:

— E ndiqni radion vazhdimisht?

— Po, shoku Enver, — i thashë.

Pastaj vazhdova:

— Shoku Enver, kur zhvilloheshin luftimet e fundit kundër pushtuesve e tradhtarëve dhe morëm telegramin Tuaj që të mos pushkatonim pa gijq kriminelët e tradhtarët me damkë që kishim

kapur, i dërguam në Tiranë ku gjyqet e popullit i dënuan sipas fajeve që kishin bërë.

— Lufta është luftë, — më tha shoku Enver, — në zjarr e sipër mund të bëhen edhe veprime të nxituara e të tepruara, nga situata, nga humbja e shokëve etj. Ndaj kërkua që për çdo rast të vendosnin gjyqet e popullit në fuqi.

Në Qafë të Koshovicës, pranë Fierit, ngaqë udhëtonim në një makinë, diç de-sha t'i thosha, po u përmbajta e nuk ia thashë. Ai, siç duket, më kishte nuhatur e më shpoi:

— Thuaje, ç'do të thoshe!

— Shoku Enver, në Kurvelesh ata shokët e pushtetit kanë filluar t'u thonë grave të vishen me fustan. Mendoj se nuk kanë të drejtë se ato mërdhijnë, pastaj janë veshje tradicionale.

Shoku Enver më tha:

— Asgjë nuk duhet me forcë, do të vijë koha që gratë e vajzat labe ta kuptojnë vetë se cila veshje është më e mirë. Sa për çitjanet, ato nuk janë veshje kombëtare, por të ardhura nga turqit. E kuptova se cili ishte mendimi i shokut Enver dhe me ato dy fjalë që më tha u sqarova dhe se si duhej të veprohej më pas.

Në konferencën e Partisë në Berat, ku mori pjesë shoku Enver, nga disa diskutantë ngriheshin dhe gjëra të tepërta. Njëri ngrihet e akuzon një shok tjetër: «Ka qenë xhandar»! Aty për aty ndërhyri shoku Enver:

— Mirë, ka qenë xhandar, po kur e në ç'rrethana?! A ka bërë të këqija, ka bërë krime?

— Jo, krime s'ka bërë, por në fillim ishte ca kohë xhandar!

Më ka mbetur në mendje sqarimi i shokut Enver:

— Kujtoni ato kohë, — tha, — dhe gjykoni: Ku do të shkonin njerëzit atëherë për të kërryer bukën e gojës, kur

s'gjendej punë gjëkundi? Ndonjë hallexhi do të vishej dhe xhandar, por, kur të gjykojmë për ta, duhet të shohim se pse veproi kështu, a ka kryer krime dhe ç'qëndrim mbajti kur nisi lufta partizane.

Pastaj u kthye nga unë që isha në krah të tij, në presidium, dhe më tha:

— Ti Shefqet do të shkosh në Tepele të në Delvinë, dhe të keni kujdes për këto gjëra! Të mos gjykohet njeriu vetëm në ka qenë xhandar apo jo... Dhe andej ka pasur xhandarë, por kur i thirri Partia dhe erdhi puna për të marrë armët, shumë u hodhën në luftë dhe luftuan jo keq, dhënë kontributin e tyre simbas takatit që kishin. Ndaj duhet pasur kujdes në këto punë. Kritika të jetë konstruktive, parimore.

Viti 1949. Me shokun Enver e shokë të tjerë shkua në Dajt për shëtitje. Po qëllonim nishan. Nuk e kisha parë ndonjëherë shokun Enver se si qëllonte dhe kisha merak se punët e Partisë e të shtetit do ta kishin penguar të stërvitej me armë siç bënim ne të tjerët. Nuk doja të turpërohej, por thashë me vete: unë do qëlloj mirë, patjetër.

Qëllua të gjithë, po asnjë s'e mori shenjën. Për çudinë tonë vetëm shoku Enver e mori shenjën me të parën.

Qëllua prapë, po prapë s'e morëm dot; se si na u lidh dora e u turpëruam. Shoku Enver qeshte dhe, me shumë da-

shamirësi, na e hidhte dhe nga ndonjë thumb. Pastaj më thotë mua:

— Ai maliheri që më dërgove, qëllon nga halli. Ishte shumë i ngrënë, sado që ishte i bukur, po ç'e do, s'qëllon mirë!

Edhe këtë e paskësh provuar shoku Enver!

Më 1949 u emërova ministër i Komunikacioneve dhe i PTT-së. Vura re se ushtria, sidomos Komanda e Përgjithshme, ishte mësuar si pa të keq të merrte kur të donte sa makina t'i duheshin nga transporti dhe, për pasojë, plani i transportit binte shumë.

Një ditë Komanda e Përgjithshme kërkoi 50 makina!

— Përse ju duhen? — i pyeta.

— Për shërbime urgjente ushtarake, — më thanë.

U bëra tym. Si mund të punohej kështu, të gjitha gjërat urgjente ishin, po kështu ne kurrë s'kishim për ta realizuar planin! Vendosa të marr në telefon shokun

Enver dhe ia tregova hallin. Më dëgjoi dhe më tha:

— Mos i jep!

S'shkoi shumë e më mori Komanda e Përgjithshme në telefon:

— Nuk i duam makinat!

— More ju i doni, — thashë me vete, — po nuk ju la kush tjetër që hoqët dorë kaq shpejt nga kërkesa.

Po atë ditë më mori përsëri shoku Enver në telefon dhe më tha:

— Vër rregull, punoni me plan, makinat mos i shkatërmoni.

— Si urdhëron shoku Enver! — i thashë me gëzim të thellë dhe i çliruar.

Është viti 1949. Në afërsi të portit të Durrësit vijnë korracatat që sovjetikët i kanë marrë si dëmshpërblim të luftës nga Italia. Admirali sovjetik fton një pjesë nga shokët e udhëheqjes sonë për drekë në korracatë. Midis pjesëmarrësve, në krye ishte shoku Enver. Në portin e Vlorës hipëm në motoskaf dhe shkuam në anije. U organizua një drekë e ngrohtë dhe e përzemërt. Më bëri përshtypje: sovjetikët pinin shumë alkool. Ne më pak, dhe me zakonet tona, me karar, si i themi. Erdhi një çast dhe admirali më gjeti mua me një gotë të madhe me raki. I bëra bisht, por shoku Enver ndërhyri e më thotë:

— Mos na turpëro, po pije, Shefqet!

E kuptova se admiralit dikush i kishte thënë «bjeri këtij (për mua), se ky e mban rakinë!». Mirëpo admiralit vështirë t'ia dilje dot; ishte shumë i fortë në pije, ashtu dukej të paktën nga kalliri. Bëra si bëra, e piva. Po sikur nuk më bëri hiç gjë. M'u duk sikur piva ujë. Atëherë mora fuqi dhe e «sulmova» admiralin me të njëjtën gotë plot për shëndetin e Stalinit, që ta detyroja ta pinte medoemos. Ai dhe shumë të tjerë e pinë dhe u bënë në qejf, gati të dehur. Muhabeti u trash.

Kur ikëm, më tha shoku Enver:


— Ama, ç'ia bëre mirë admiralit! Po si e ndien veten? — dhe qeshte.

— Shumë mirë, shoku Enver.

Ai prapë më ngacmoi:

— Ke hak, Shefqet, admiralin kot mburrej! Të mos e kisha të ndaluar nga doktori, pa do shihje se ç'të të bëja! — dhe qeshte përsëri me shumë humor. Unë ia ktheva:

— Shoku Enver, unë pi raki, por nuk e di pse sot m'u bë ujë, më shumë nga gëzimi, shkriva në djersë se ishte dhe nxehtë, dhe më duket se e nxora djersë të tërë...





Na vjen një telegram prej SHBA-së nga një tradhtar, i quajtur Çekrezi, ku thoshte: «Dorëzoni pushtetin» etj., etj. E mora telegramin i zemëruar, shkova te një nga sekretarët e Komitetit Qendror dhe i tregova se ç'kërkonte edepsëzi nga Amerika. Në këtë kohë futet në zyrën e sekretarit shoku Enver.

— Shefqet, si je, si ia çon me shëndet, me punë? — më pyeti.

Iu përgjigja dhe, meqë ishte rasti, i tregova me gojë përmbajtjen e telegramit.

— Mos u bëj merak! Sa do të marrësh e do të dëgjosh ti nga këto gjepura..., — më tha dhe filloi të më pyesë për transportin në Korçë. Në atë periudhë partiza-

nët grekë ishin grumbulluar afër kufijve tanë (taktikë e gabuar e tyre). I them shokut Enver:

— Pse ata nuk po hidhen në thellësi, në prapavijat e tyre? Ai më tha me humor:

— Janë në prapavijat e tua! Dome-thënë e humbën luftën, s'e gatuan dot.

Më 1950 shkova në Çekosllovakia, në festën e çlirimit të tyre, si kryetar i delegacionit. Shoku Enver më porositi që të mësoja mirë rregullat e paraqitjes civile, zyrtare, diplomatike etj. Unë isha ministër i Komunikacioneve e PTT-së, po rrija akoma me uniformë gjenerali.

Kur u ktheva nga Çekosllovakia në Rumani, kërkova të takohesha me ministrin e Komunikacioneve, se kishim një lokomotivë për të marrë. Ministri më dha takim pas një jave, kur unë do të largohesha. Meqenëse ma shtyu aq larg, unë nuk pranova të takohesha me të dhe u largova. Por në vapor mendoja se si do t'i thosha shokut Enver po të më pyeste.

Isha shumë i shqetësuar se mos bëra gabim, pasi dhe ambasadori ynë në Rumani më bëri presion që unë të pranoja të piqesha. Shkova te shoku Enver. Më pyeti dhe unë i thashë ashtu si veprova.

— Mund të kem gabuar, shoku Enver!

I vrenjtur më tha:

— Jo, s'ke bërë keq.

Për mua kjo ishte kënaqësi dhe u qetësova.

Kaluan ca kohë dhe një ditë shoku Enver më thotë:

— Ty të pëlqen uniforma ushtarake, Shefqet.

— Po! — i them.

— Mirë, mbaje, por tani që je ministër, quhesh dhe diplomat, — dhe qeshi me lezet. Qysh atëherë e hoqa uniformën, por sikur humba diçka. Nuk e kisha hallin te grada, por më pëlqenin çizmet, xhaketa e mbyllur e të tjera. I hoqa gradat, she-njat, por xhaketën e mbajta të mbyllur dhe çizmet i mbaja edhe në verë.

Pas ca kohe, kur isha kthyer nga një udhëtim në Gjermani, me një delegacion tonin, shoku Enver më takoi dhe mbasi

më pyeti se si shkova (se dhe u sëmura atje), më tha me humor:

— Me xhaketë të mbyllur vajte dhe në mbrëmjen solemne?

— Po, shoku Enver, kështu vajta, — i thashë dhe shtova. — Atje u poqa me shumë njerëz, edhe me Molotovin.

— Molotovi nuk do t'ju thoshte juve pse erdhët me xhaketë të mbyllur, — më tha dhe qeshi. U turpërova dhe që atëherë e hoqa fare dhe xhaketën e mbyllur.

Jemi në Kuç dhe, në një moment, kryetari i lokalitetit të Progonatit i tha shokut Enver:

— Rruga nga Salaria në Kurveleshin e Sipërm nuk po bëhet dhe populli e kërkon.

Shoku Enver m'u drejtua mua. Mblo-dha supet, se shumë herë kisha ndërhyrë, por dikush kishte thënë që në Kurveleshin e Sipërm të mos bëjmë rrugë, «për arsye strategjike»!

Kur u larguam nga Kuçi, ia shpjego-va më mirë se ku që rezistenca. Shoku Enver qeshi dhe tha:

— Do ta marrim unë e ti përsipër!
Kur shkuam në Tiranë, ai vetë dha

udhëzimet e duhura. U thirra dhe unë e
organizuam punën me shokët e ushtrisë.
Popullit të Kurveleshit të Sipërm iu bë
rruga në të dyji drejtimet vetëm në kohën
e Enver Hoxhës!

Jemi në Peshkopi. Shoku Enver ka ardhur për vizitë dhe ne e shoqërojmë. Në një mbledhje të ngushtë me kuadrot, një sekretar partie, duke raportuar tha:

— Shoku Enver, në katundin filan u bënë zgjedhjet për në këshillin popullor dhe sekretarin e Partisë të fshatit populli nuk pranoi ta zgjidhte në këshill.

— Pse? — e pyeti shoku Enver.

— Kishin ankesa, s'e donin, — shpjegoi sekretari. E tregonte si shenjë të keqe.

— Atë komunist që s'e do populli, s'e do as Partia, prandaj dhe nga Partia të hiqet, — iu përgjigj shoku Enver dhe, kur të gjithë mbetëm në heshtje, ai vazhdoi:

— Anëtari i Partisë duhet të jetë zemërmadh, i ndershëm, i dashur me popullin, atëherë populli e do dhe e nderon. Por po qe arrogant, përvetësues e me të tjera vese të këqija, atë s'e do e s'ka pse ta dojë populli. As për Partinë një element i tillë s'vlen asnjë pare.

Thirrem në Byronë Politike se isha grindur me Tuk Jakovën, i cili ishte zëvendëskryeministër. Ishte ankuar se gjoja nuk kisha respekt për të etj. Shokët e gjykuan drejt çështjen dhe kritikën ishin konstruktive, në frymë partie. Pas kësaj analize shoku Enver më komunikoi se Byroja Politike kishte menduar që të shkarkohesh nga detyra e ministrit të Komunikacioneve dhe PTT-së dhe të emërohesha ministër i Minierave dhe i Gjeologjisë.

— Unë ministër i Minierave dhe i Gjeologjisë?! — i thashë shokut Enver me habi.

— Po, — më tha ai duke qeshur, — ti!

— Po unë, shoku Enver, s'e njoh fare naftën, s'di nga del dhe si del, duhet të jesh inxhinier për këto punë!

— Po, e dimë që nuk di nga nafta, por kështu janë kohët. Ti ke partishmëri, disiplinë, organizim dhe ndihmën e Partisë. Këto i duhen tani naftës dhe gjeologjisë në tërësi.

Aty për aty m'u duk se do ta plotësoja këtë besim që më dha Partia.

Pas ca kohësh shoku Enver më thirri në zyrë dhe më pyeti mbi rezervat e naftës, të kromit, të bakrit etj. I raportova dhe, midis të tjerash, i them se në derveret e Rubikut, simbas shenjave të gjeologëve, kemi 15 milionë tonë rezerva bakri! Shoku Enver vuri buzën në gaz.

— Kështu qoftë, — tha, — por nuk më besohet, do të të kenë gënjyer gjeologët!

Dola, kërkova të dhëna të sakta dhe rezultoi ashtu siç tha shoku Enver dhe jo siç thashë unë me gjeologët.

— Kam të dhëna se nafta ka 25 përqind ujë, — më tha në një takim tjetër shoku Enver. — Kjo sasi duhet zbritur nsa plani, se uji nuk mund të bëhet naftë. Mirë është që këto gjëra të saktësohen që në fillim dhe jo të detyrohemi tani të ulim planin shtetëror.

— Plani është plan, ne do të mundohemi ta realizojmë aq sa është caktuar, — i thashë.

— Jo, në asnjë mënyrë! Nuk duhet të vrasim klasën punëtore! Duhet të jemi realistë! — theksoi shoku Enver.

Më thërrasin në Qeveri. Maqo Çomo, ministër i Kontrollit në atë kohë, kishte raportuar se një shok kryesor në drejtorinë e naftës gjoja ishte antisovjetik! Mehmet Shehu, i zbardhur nga inati, ma thotë këtë në prani të Maqos.

— Nuk është e vërtetë, — u them, dhe me kaq forcë kundërshtova sa puna arriti deri aty sa ata më kërkuan që të lëshoja deklaratë! U tregova i gatshëm. Erdhi puna që unë mbasdite do të çoja deklaratën.

Kur po largohesha Maqo Çomoja më tha:

— Bëje me dorë, jo me makinë!

Nuk m'u durua dhe iu përgjigja ashpër:

— Kjo është puna ime.

E shkrova dhe e dërgova deklaratën.

Mehmet Shehu e Maqo Çomoja e çuan punën e «antisovjetizmit» të shokut tonë të naftës gjer në Byronë Politike! Më thirrën dhe mua në atë mbledhje dhe nisi analiza.

Shoku akuzohej për «antisovjetik», sepse kishte dhënë urdhër që të mos u jepeshin disa specialistëve sovjetikë makinat që kishin kërkuar.

— Urdhrin, — thashë, — s'e ka dhënë ai, por unë.

— Ç'është ky urdhër? — më pyetën shokët, — përse i ke ndaluar?

— Sepse specialistët sovjetikë të naftës i kërkonin makinat që të vinin në plazh për banja në një kohë kur s'na ecte plani, makinat na mungonin dhe neve na vinte festja vërdallë.

Shoku Enver aty për aty ndërhyri:

— Shoku ka zbatuar urdhrin. Nuk duhet që të vijnë gjëra të tilla gjer në Byro, — dhe e kaloi diskutimin në tjetër drejtim: porosi për punën në sektorin e naftës.

Më merr në telefon shoku Enver:

— Informohem se hotel - «Dajti», ku banojnë të huaj, nuk ka qymyr për ngrohje. Përse ndodh kjo, përse s'ka qymyr?

Filloj të tregoj arsyet, por shoku Enver në mënyrë të prerë më thotë:

— Nuk na duhen arsyet se pse s'ka, na duhet qymyri. Merrni masa urgjente për të zgjidhur problemin; më njoftoni përfundimin!

E morëm seriozisht punën dhe problemi u zgjidh por një ditë, pavarësisht se «arsyet që na pengonin» mbushnin një thes!

Në një mbledhje të Byrosë Politike ishte thirrur në raport drejtori i minierës së Memaliajt. Ishte fare inaktiv, planet nuk realizoheshin dhe ai, në vend që të kërkonte shkaqet, filloi të thoshte edhe para Byrosë Politike e shokut Enver gjëra që nuk qenë të vërfeta. Nuk m'u durua:

— Nuk informon drejt, nuk është kështu, — thashë në një moment.

Sjellja ime e nxituar e revoltoi shokun Enver. Kur u largua drejtori nga mbledhja e Byrosë, më kritikoi.

— Nuk është e drejtë, Shefqet, që ti, si kuadër, ta presësh në mes shokun. Ai vërtet mund të jetë inaktiv, siç thua ti, por duhet maturi kur bisedon e diskuton me ta.

Shoku Spiro Koleka, në atë kohë zëvendëskryeministër, që mbulonte edhe Kontrollin e Shtetit, ngulte këmbë se në minierën e Selenicës nuk ishte realizuar plani, dhe se shokët e drejtorisë së minierës kishin raportuar shifra fiktive. I them se raportimi i minierës është i saktë, e rreme është informata që ju kanë dhënë Juve.

— Kontrolli i Shtetit thotë të vërtetën. Unë do të njoftoj Partinë, — m'u përgjigj ai.

Nuk vonoi dhe pas një muaji, nga një organizim i ri në dikaster, shoku Koleka u emërua ministër i Minierave e

i Ndërtimit, kurse unë u emërova në Kontrollin e Shtetit.

Më merr një ditë në telefon e më thotë:

— Shefqet, ajo puna e bitumit ka qenë ashtu siç thoshe ti, nuk ka deficit. Më paskëshin gënjyer.

Ia tregova në një bisedë të lirë shokut Enver këtë që më ndodhi me shokun Koleka.

— E kishe radhën ti ta kundërshtoje, — më tha me shaka. — T'i thoshe se «s'është e vërtetë, ka deficit», — e pastaj vazhdoi, — po nuk di tjetrën ti! Shoku Koleka na ngriti në Byro se duhen 150 punëtorë për minierën e Memaliajt. «Por kur ishte Shefqet Peçi ministër i Minierave dhe kërkoi 75 punëtorë pse ia refuzove? — i thashë. Na the që nuk ka nevojë. Pse tani që vajte ti u dashkan 150?!». E di si m'u përgjigj Spiroja, — vazhdoi shoku Enver gjithnjë duke qeshur: — «Qenka e vërtetë, karrigia përcakton ndër-gjegjen!»

Viti 1951, jam shumë sëmurë. Shoku Enver është në Moskë, te Stalini. Kur u kthye, erdhi e ndenji në shtëpinë time dhe urdhëroi të nisesha për në Bashkimin Sovjetik sa më parë, për t'u kuruar. M'u duk se u shërova, dhe me të vërtetë u shërova!

Në mbledhjen e Plenumit të KQ të Partisë, ku u analizua veprimtaria armiqësore e Tuk Jakovës dhe e Bedri Spahiut, diskutova pothuajse i fundit. Ishin momente jo të zakonshme. E dënova veprimtarinë e tyre antiparti si gjithë shokët. Shoku Enver në pushim m'u afrua e më tha:

— Shumë mirë diskutove!

— Shoku Enver, s'kam luftuar për JBedri Spahiun e Tuk Jakovën, por kam luftuar për popullin dhe për Partinë, — i thashë dhe ai ma ktheu:

— Tamam! Njerëzit me partishmëri kështu mendojnë dhe kështu veprojnë.

Ndodheshim në festën e Poçemit, në Mallakastër. Do të gdhieheshim në shkollën e Hekalit. Ishte rregulluar mirë aty, ishim shtruar këmbëkryq! Shoku Enver, si ngahera me humor, i thotë xha Jahos (Gjolitikut):

— Po në Kuç bëhet misri mirë?

— Si jo, shoku Enver, ta preç me sëpatë, aq i madh bëhet, — iu përgjigj xha Jahoja.

Shoku Enver heshti pak, pastaj m'u drejtua mua me buzë në gaz:

— U bëka shumë misri në Kurvelësh!

— Po, shoku Enver, bëhet, por jo sa për ta prerë me sëpatë, — iu përgjigja unë.

Krisi gazi, qeshi edhe vetë xha Jahoja dhe u kthye muhabeti në humor e shaka.

Shoku Enver, për t'i bërë qejfin xha Jahos që ishte nga Kuçi, më shpoi mua:

— Në Picar mund të mos bëhet, se picarjotët e Shefqetit s'e punojnë mirë tokën...

— Nuk duam ta prishim me picarjotë, se vemi e verojmë me bagëti, pasi kanë gjethe.., — i tha xha Jahoja po me të qeshur.

Të nesërmen në Poçem bëja shaka me xha Jahon duke i thënë:

— Kur do të vemi në Kurvelesh, ta presim misrin me sëpatë?

— Po ti e di more Shefqet, që unë nuk dua të them që s'bëhet gjë në ato vende, se e kam të vështirë! — më thoshte xha Jahoja. — Qysh t'i them Komandantit, s'u bëka misri në Kurveleshin me nam?!

Erdhi lajmi se Sherif Zeneli ishte vrarë aksidentalisht. Më thirri shoku Enver dhe më porositi të vete unë dhe një shok tjetër në varrim, në Delvinë. Ashtu u bë.

Kur u ktheva, u poqa me shokun Enver dhe i tregova për ceremoninë e varrimit, për nderimet që i bëri populli e Partia djalit të Labërisë.

— Si të mos e përcillte populli me nderim vëllanë e Asim Zenelit! Pastaj Sherifi kishte edhe meritat e tij si luftëtar e kuadër, — më tha shoku Enver dhe mbushi sytë me lot.

Thashë me vete: Si nuk i ka mbetur kuadër pa njohur! Një për një i njeh të gjithë dhe njëlloj mendon e shqetësohet për të gjithë!

Ishim në festën e Kuçit. Kur u larguam, rrugës në makinë shoku Enver më pyet për malin e Çikës:

— Sa metra është?

— Nuk më kujtohet, shoku Enver,
— i thashë.

Shkuam më poshtë. Më pyeti për malin e Picarit se sa hektarë tokë ka.

— Aty afër 80 hektarë, — iu përgjigja. Ndenji dhe pak dhe krreu nga xhepi një defter me shënime dhe tha:

— Unë i mbaj të shkruara!

Sikur deshi të më thoshte me lezet: «Kështu duhet ta kesh dhe ti». Që atëherë e mbaj defterin e shënimeve në xhep. Kur mbërritëm në Vlorë, shoku Enver do të ni-

sej me aeroplan për Tiranë. Avioni kishte një avari dhe ishte duke u ndrequr. Ndërkohë vjen oficeri i tij dhe i thotë:

— Mendoj të mos nisemi me aeroplan!

— Mendoni ju kështu apo piloti? — i tha shoku Enver me të qeshur, dhe u nis me aeroplan për Tiranë.

Mbeta me gjak të ngrirë, sa mora vesh që mbërriti shëndoshë e mirë. Por ama nuk i thashë mos u nis.

Në një mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, në vitin 1954, unë dhe shoqja Nexhmije ndodheshim pranë njëri-tjetrit dhe përballë shokut Enver. Në atë kohë shoku Enver pinte shumë duhan. Edhe në atë mbledhje ai i ndizte cigaret njëren pas tjetrës. Shoqja Nexhmije, që e kisha në krah, më pëshpëriti me të ulët që t'i them shokut Enver ta ndalonte duhanin se na mbyste tymi.

— Dakord jam, — i them, — shkruani ju një letër dhe e nënshkruaj unë.

Shoqja Nexhmije e shkroi letrën ku i lutej shokut Enver të ndërpriste duhanin, unë e nënshkrova dhe ia dhashë shokut Enver. Pasi e lexoi, ai buzëgaz

shkroi në një pusullë: «Do ta zbatoj porosinë», na e dha dhe menjëherë e shoi cigaren.

Mbas 2 minutash ndezi cigare tjetër dhe njëkohësisht më hodhi edhe mua një të tillë. E mora cigaren, që e futa në xhep se nuk e pija duhanin, dhe i them shoqes Nexhmije:

— E sheh, e zbatoi porosinë tonë.

Shoku Enver e kuptoi, dhe me të mbaruar cigaren, ndezi një tjetër, duke më hedhur edhe mua cigaren e dytë.

— U bënë dy cigare në xhep! — i them shoqes Nexhmije.

— Lëre, — ma ktheu ajo, — kështu si ka nisur do të ta mësojë dhe ty. Por këtë gjë mos ia zbato!

Unë këto cigare i ruajta në sirtarin tim 15 vjet, derisa u shkoqën.

Mbas disa ditësh ndodheshim në shtëpinë e Partisë. * Shoku Enver luante bilaro dhe unë pranë tij po ndiqja lojën. Për një çast ndaloi lojën dhe ndezi një cigare.

— Shoku Enver, — i drejtohem, — harruat të më jepni dhe mua cigaren.

*) Është fjala për shtëpinë e pritjes, të pushimit, në Tiranë.

Qeshi me të madhe e plot gëzim. Futi dorën në xhep dhe nxorri një brisk (biçak) të bukur, i cili hapet në të dy anët. Duke më zgjatur briskun më thotë:

— Na këtë brisk e mbaje dhe jo cigaret që bien erë.

E mora briskun që më dhuroi shoku Enver me kënaqësi të madhe, duke i thënë se do ta ruaj me kujdes gjithmonë; dhe në fakt që nga ajo ditë nuk e mora asnjëherë në xhep, por e kam mbajtur dhe ruajtur vazhdimisht në sirtarin e tavolinës së punës. (Po ashtu si gjë të shtrenjtë ruaj edhe një këllëf syzesh. Ishim në një mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror në një tavolinë me shoqen Nexhmije e në një moment ajo më tha: «S'ta shoh dot këtë këllëf të vjetër, ti je i ri» dhe më dhuroi këllëfin e syzeve të saj.)

Disa vjet më pas ndodheshim në shtëpinë e Partisë. Shokët e tjerë nuk kishin ardhur akoma dhe, meqë ishim vetëm, shoku Enver më porosiste për disa çështje të kontrollit. Nxora menjëherë stilolapsin dhe fillova të mbaj shënimet e rastit. Stilolapsi që kisha me vete qe shumë i mirë dhe i bukur. Aty për aty m'u kujtua bris-

ku që më kishte dhuruar kohë më parë shoku Enver dhe i drejtohem:

— Shoku Enver, më falni dhe mos ma merrni për shkëmbim, dua t'ju dhuroj këtë stilolaps të bukur.

Qeshi dhe m'u përgjigj:

— Do ta marr me gjithë qejf dhe nuk do ta quaj si kthim borxhi, por, shiko se mos të nevojitet.

— Tek unë ky stilolaps nuk lodhet shumë, prandaj duhet të vejë atje ku lodhet, — i thashë.

Qeshi përsëri, e mori stilolapsin dhe e futi në xhep.

Shoku Enver më pyeti për Kurveleshin dhe Labërinë dhe unë i fola gjatë. Në mes të tjerash i thashë se ferma e Tepelenës prodhoi shumë zarzavate, domate e të tjera, po nuk shkojnë s'i ha populli.

— Pse nuk i ha? — pyeti shoku Enver.

— Sikur s'i duan, — i them unë.

— Sa e kanë çmimin, shoku Shefqet?

— 40 lekë*.

— Ja, pra, arsyeya, — tha shoku Enver, — i bëni 10 lekë që t'i hanë. Po ç'bëheh këto perime që mbeten?

*) 40 lekë të asaj periudhe janë të barabartë me 4 lekë të tanishme.

— I merr Gjirokastra.

— Jo, nuk duhet t'i marrë Gjirokastra, Gjirokastra prodhon vetë të sajat. Tepelena duhet të ulë çmimin.

Në vazhdim i thashë se gratë e Kurveleshit dhe të Labërisë janë të kënaqura që hoqën veshjen e tyre të hershme e të rëndë dhe për këtë këndojnë edhe një këngë:

— Ç'thonë në atë këngë? — pyeti me interesim.

I recitova vargjet e mëposhtmer

*O Enver të keqen nëna,
Na hoqe rrobat e rënda
Dhe na veshe allafrënga.*

Bëri buzën në gaz dhe tha:

— Mërdhijnë?

— Jo, shoku Enver, — iu përgjigja.

— Po, po, mërdhijnë se është vend i ftohtë, — tha dhe më pyeti: — Sa lesh u jepni grave të Kurveleshit dhe të Labërisë për të bërë triko, çorape etj. ?

— Këtë nuk e di, shoku Enver.

Pas disa ditësh shoku Enver kishte urdhëruar Ministrinë e Tregtisë që grave të Kurveleshit dhe të Labërisë t'u jepej nga një sasi leshi për triko, çorape e veshje të tjera.

Pas këtij urdhri të shokut Enver më morën në telefon nga Ministria e Tregtisë e më thanë:

— Na kërreve punë, hoqe leshin që kishim parashikuar në planin e eksportit!

— Jua hoqi Enver Hoxha dhe jo unë, — iu përgjigja, — sepse mua s'më shkonte në mend një gjë e tillë, por shokut Enver, i cili edhe në gjumë mendon për të mirën dhe begatinë e popullit.

Pak ditë pas Konferencës së Partisë të Tiranës, të vitit 1956, në një takim në shtëpinë e Partisë, tek bisedonim, shoku Enver tha duke m'u drejtuar mua:

— Pse nuk flisnit në Konferencë, ç'bënin anëtarët e Komitetit Qendror, pse nuk i demaskonit armiqtë, ç'prisnit?!

M'u mbyll goja nga përgjegjësia. E pashë qartë se ata që më kishin frenuar (shokë me përgjegjësi më të madhe në atë kohë, Mehmet Shehu e Beqir Balluku) kishin gjoja «frikë» për mua se mos nga temperamentimi im i ashpër e i rrëmbyer, në vend që të vija vetulla, nxirrja sy! Më thanë se «është e vështirë kapja e situatës» dhe as ata s'u ngritën! Veç kur ma

tha shoku Enver, atë ditë më mbeti peronë në zemër akoma më tepër. Sigurisht nuk ia thashë shokut Enver arsyen e frenimit, por shaja veten: të mos kisha dëgjuar njeri.

— Sidoqoftë, përpara do të kemi të tjera tallaze, — na tha shoku Enver.

M'u kujtua ajo shprehja popullore: të bënin të gjitha mizat mjaltë!

Ndodheshja në Bashkimin Sovjetik për pushime, në një kohë që atje ishte edhe shoku Enver. Mori vesh se ku pushoja dhe të nesërmen erdhi vetë aty, në Barviha. Unë me shoqen time, Katon, porrim në dhomë. Kur shohim, të alarmuara e me vrap njëra pas tjetrës, tri punëtoreshë që punonin aty! Mundoheshin secila nga të tria ta jepte lajmin e para:

— Tavarish Enver, tavarish Enver!

Tek e fundit e kuptuam që na thoshin se shoku Enver mbërriti përposh në sallë dhe na kërkonte ne. Shkuam menjëherë.

— Të gjeta dhe këtu, o Shefqet Peçi!
— na përshëndeti shoku Enver me buzë në gaz, me një shkop të shkurtër në dorë.

Ç'mund të them unë për ato çaste emocionante! Ku kishte gjë më të bukur dhe më të gëzueshme për mua e Katon atje larg Shqipërisë, vendit tonë të dashur, të takonim Enverin tonë! Mbase ka luam disa orë shëtitje, shoku Enver u largua dhe na ftoi bashkë me Katon të shkonim të nesërmen për drekë. Shoku Enver qëndronte në një vilë ku kishte banuar dikur Stalini. Shkuam. Na priti me shoqen Nexhmije. Shoku Enver i tha Katos të zinte vend mbi mua.

— E pranoj, — i thashë, — s'kam ç'të bëj!

Shoku Enver e shoqet u shqyen në gaz. Pastaj më tha:

— E dija që ti do ta thoje këtë.

Më pas i pyeta punëtoret që na dhënë lajmin.

— Dje, kur erdhi ai shoku, kush ju tha juve që ishte shoku Enver?

— Pse, — thanë ato, — të fshehur do të na e mbash? Ai ishte!_E njohjm nga fotografia që kemi varur. Enver Hoxhën e njeh gjithë bota, jo vetëm ne.

Edhe ato ishin shumë të gëzuara që e panë dhe ajo që foli me të fluturonte nga gëzimi.

Jemi në shtëpinë e Partisë. Shoku Enver thotë:

— Një qytetar nga Pogradeci më bën një letër ku thotë se në Mokër, në një shpellë, diku aty afër nga Guri i Shpuar, paska të dhëna se gjoja në kohën e lashtë janë fshehur thesare të mëdha. Ajo çka më shqetëson është fakti se ky qytetar më ka shkruar më se dy herë dhe unë qysh në fillim kam dhënë porosi ta shikojnë' çështjen, por shokët e kanë lënë në harrësë, që t'i themi dhe këtij qytetari «hajde na e trego ta zgjidhim».

Të nesërmen pas kësaj bisede përgatita planin dhe ngarkova një shok zëvendësministër ta ndiqte problemin nga

afër e menjëherë. U kompletuan mjetet e nevojshme për t'u varur me litar në sterë, bile edhe vetë shoku ynë, i gatshëm gjithmonë, bashkë me të interesuarin zbritën në sterë. E panë, ishte me të vërtetë sterë interesante, por nuk gjetën gjë. Iu mbush mendja dhe atij që bënte letra. Njoftova shokun Enver një natë në shtëpinë e Partisë. Shoku Enver, që e pëlqente shumë korektesën, ngriti zërin:

— Shumë mirë ke vepruar. Nuk kishte dhe s'ka rëndësi thesari gjoja i fshehur, por duhej bindur i interesuari se letrat e kërkesat që vijnë te ne s'mbeten sirtareve. Të mësojnë ata shokët që e dinin çështjen më parë, bile kishin dhe porosi nga ne (e kishte fjalën për Liri Belishovën), por s'e vënë ujët në zjarr.

Jemi në Moskë, në mbledhjen solemne të 40-vjetorit të Revolucionit të Tetorit. Kryetar delegacioni është shoku Enver. Delegacionet shtetërore e të partive komuniste e punëtore ishin vendosur nëpër tavolina të pajisura me kufje për të dëgjuar në disa gjuhë.

Delegacioni ynë e dëgjonte frëngjisht, kurse unë italisht, se atë gjuhë dija. Përkthim shqip nuk kishte. Një natë më parë, gati isha gdhirë pa gjumë. Ndërsa vazhonte mbledhja solemne, shoku Enver ngandonjëherë lëvizte çelësin e aparatit të dëgjimit dhe menjëherë unë s'dëgjoja më e i thosha:

— Shoku Enver, ma mbylle, nuk dëgjoj!

Ai bënte buzën në gaz dhe e vinte prapë çelësin. Vazhdoja të dëgjoja në rregull. Më provonte nëse dëgjoja apo i mba-ja kot në vesh kufjet, se mos më kishte mundur pagjumësia e mbrëmshme!

Në një nga ato ditë që qëndruam në Moskë na priti kryeministri i Bashkimit Sovjetik, Bulganini. Në zyrën e tij ishte varur në mur fotografia e Leninit. Shoku Enver zhvilloi bisedime me të dhe, në mes të tjerash, tha se Bashkimi Sovjetik ishte një fuqi e madhe, me potencial të madh... etj. Bulganini, domethënë kryeministri, nënqeshi, s'di përse, dhe se si shtrëngoi grushtin më vete, pa folur fare.

Kur do të dilnim, ai na dha dorën dhe na përcolli te dera.

Kur u larguam, shoku Enver na tha:
— I lodhur dhe i vrarë Bulganini.

Ne të tjerët nuk folëm fare. Sa larg e sa hollë e kishte nuhatur këtë' gjë shoku Enver. Nuk shkoi shumë dhe Bulganini u shkarkua nga detyra.

Gjatë ditëve që qëndruam në Moskë shikoja që të gjithë sekretarët e partive komuniste motra donin të takoheshin me shokun Enver dhe ky, me buzëqeshjen e tij të zakonshme, me fjalën e mençur e me pamjen e hijshme, takohej me ta duke lënë përshtypje nga më të mirat.

Në një nga ato ditë u ndërpre në veprimtaritë festive në Kremlin, sepse do të shkonim në varrimin e shokëve të delegacionit rumun që u vranë aksidentalisht me aeroplan duke ardhur për në Moskë në festimet e 40-vjetorit të Revolucionit të Tetorit.

Në ceremoni e mori fjalën një shok rumun, i cili fliste shumë ngadalë. Nuk

merrej vesh asgjë se ç'thoshte. I them shokut Enver se ai nuk dëgjohet fare.

Me zë të ulët shoku Enver më tha:

— Po sikur të ishe ti, Shefqet e të të vriteshin shokët, si do të flisje, me ton të lartë?

Mbeta me gojë mbyllur.

Delegacioni shqiptar ishte vendosur në një vilë të madhe me shumë dhoma diku jashtë Moskës. Shoku Enver banonte në katin e sipërm.

Në një nga ato ditë unë kisha shkuar të takoja djalin tim, Agronin, student. Kur u ktheva, fratem në dhomë dhe gjej aty shokun Enver e shoqen Nexhmije që bisedonin me gruan time, Katon. Shoku Enver më thotë me lezet dhe me buzë në gaz:

— E morëm vesh që ti shkove në qytet, kurse Katon e le, nuk e more pas, dhe i erdhëm për vizitë, që të mos mër-zitej. Ti, Shefqet, sikur e ke të vështirë të udhëtosh me gra, apo jo.

— Shoku Enver, ju them të vërtetën këtë të metë e kam, por do ta riparoj në të ardhmen, — i thashë.

— Ta shikojmë, — tha, — do ta pyesim Katon nganjëherë, — dhe qeshën të tre.

Qesha edhe unë bashkë me ta.

Shoku Enver e dinte që isha kujdesur për pastrimin e zbulimin e shumë bodrumeve të mbuluara me llomija në kalanë e Gjirokastrës.

Një ditë m'u drejtua e duke qeshur më tha:

— Sado që u mundove, thesarin e Ali Pashës nuk e gjete dot!

Iu përgjigja po me të qeshur:

— Akoma s'e kemi humbur shpresën dhe mund ta gjejmë, shoku Enver!

— Regjimet e mëparshme, — vazhdoi shoku Enver seriozisht, — në mënyrë barbare e kanë prishur kalanë. Jo që s'e mbanin mirë. por kanë prishur dhe muret për t'i bërë fushë stërvitjeje. Ne duhet të

bëjmë gjithçka për t'i ruajtur këto monumente madhështore, që tregojnë kulturën e vjetër të popullit tonë. Ky është thesari i vërtetë që duhet të zbulojmë e të restaurojmë dhe jo legjendat për thesaret e Ali Pashait.

Dhe filloi të jepte udhëzime për mirëmbajtjen e kalasë. Midis të tjerash, për sahatin tha se «mirë e kanë bërë, por ai duhet të ruajë karakteristikat e vjetra». Po me porosi të tij, në kala nisi puna për muzeun e armëve.

Delegacioni i Partisë me në krye shokun Enver po nisej për në Moskë, për të marrë pjesë në Mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtore të nëntorit 1960.

Nuk do t'i harroj kurrë ato çaste emocionante të asaj dite që përcollëm shokun Enver me shokët e tjerë të delegacionit në aerodromin e Tiranës. E dinim se i dërgonim në gojën e ujëve...

... Kthimi shëndoshë e mirë në fund të nëntorit i delegacionit gëzoi gjithë Partinë e popullin. Pasi kishin bërë tërë atë rrugë me tren, u nisën me aeroplan nga Italia dhe erdhën natën në aerodrom. Kur zbritën në tokën shqiptare, në tokën tonë, atëherë na zuri gjumi rehat.

Një ditë më pas i them në shtëpinë e Partisë:

— Tani u duk hapët tradhtia e tyre, në imperializëm do të përfundojnë këta, shoku Enver.

Më hodhi dorën në sup e më tha:

— Lufta është shumë e gjatë, rrënjët e tradhtisë janë të thella.

Isha me shërbim në Delvinë (Saran-dë) kur sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit më thotë:

— Do të vijë shoku Enver dhe duhet të dalim ta presim.

— Ç'udhëzime keni? — e pyeta.

— Të mos dalim! Do të bëjë një vizitë pune.

— Duhet të veproni siç keni udhëzimet, — i thashë.

— Jo, jo, — më thotë ai, — ne do ta presim, po duam të vini edhe ju.

— Jo, porosia është e qartë dhe unë nuk kam pse të vij, — i thashë dhe shkova në Mursi ku kisha ca punë.

Ata e pritën shokun Enver dhe, ç'ësh-

të e vërteta, atij nuk i erdhi mirë për prirjen me ceremoni që i organizuan. Kur vij unë në pasdreke, më thonë se «na doli fjala jote»! Meqë punën që kisha e mbarova, u thashë shokëve se do të doja të largohesha herët në mëngjes. Po atë ditë shoku Enver e mori vesh se ndodhesha në Sarandë dhe kërkoi të vija të piqesha me të. Vajta. Aty qenë edhe shokë të tjerë. Më pyeti se kur kisha ardhur.

— Dje, — iu përgjigja.

— Po ku ishe sot, në Mursi?

— Po, shoku Enver, — i thashë. — Kisha punë.

Tundi kokën, dhe në këto fjalë e sipër i tha shokut Piro Kondi, i cili e shoqëronte në atë vizitë:

— Kujtimet e shokut Shefqet më pëlqyen. Duhet të rekomandoni që t'i lexojnë shokët!

Mua filluan të më bien djersë. S'kishte veç një a dy muaj që kisha botuar një vëllim me kujtime nga vitet e Luftës Nacionalçlirimtare dhe ja ç'surprizë e madhe e gëzim!

Në Korçë kishte rënë tërmet e kishte shkaktuar dëme jo të pakta. Ngarkohem nga shoku Enver dhe shkova menjëherë.

Pas 24 orëve mbërriti dhe vetë shoku Enver. Kërkoja që të shpejtohej pastrimi i rrugëve sa më parë nga pasojat e tërmetit, mirëpo më dukej se pak po bëhej. Shoku Enver erdhi dhe nuk la asnjë lagje e rrugë pa e parë. Në mbrëmje u thashë shokëve se unë do të largohesha natën për Tepelenë, se nesër atje bëhej mbledhja e plenumit, ku isha i deleguar. Shoku Enver e mori vesh dhe me të qeshur më tha:

— Mirë do të bëhet që të largohesh, Shefqet, sepse këta shokët duan të punoj-

në të lirë, kurse ti u bëhesh havale. Por kij kujdes, natën mos udhëto, se je dhe i lodhur.

Shokët e rrethit i thanë:

— Jo, shoku Enver, ne na ka ndihmuar shumë shoku Shefqet!

— Po, po, ju ka ndihmuar, por ju s'keni bërë ashtu siç do Shefqeti, punë të shpejtë e të pastër.

M'u duk sikur na kishte dëgjuar që ne ishim «acaruar» me njëri-tjetrin për interes të punës! Ushtria ishte e para në zhdukjen e pasojave të tërmetit dhe punonte shumë mirë, kurse unë u thosha se «pushteti pret nga ushtria çdo gjë!» Në të vërtetë të gjithë, popull, ushtri e pushtet punonin shumë mirë, por unë u thosha «ju më pak», «ata më shumë» që të ndizja shpirtin e garës, të shpejtoheshin më shumë ritmet.

Kisha marrë porosi të veçantë nga shoku Enver që të kujdesesha për çdo gjë për xha Jaho Gjolicun, i cili vite më parë, kur shkante për një takim me zgjedhësit në Ramicë të Vlorës, ishte paralizuar. Qëndroi 16 vjet i paralizuar, por gjykimin e ruajti gjer në fund. Ishte kurdoherë i rrethuar nga dashuria e kujdesi i posaçëm i Partisë e i pushtetit, nga familja e të afërmit. Vetë shoku Enver e vizitonte herë pas here në shtëpi, përveç interesimit të përhershëm për të. Sa herë më takonte nëpër mbledhje, për punë ose në shtëpinë e Partisë do të më pyeste patjetër:

— A ke qenë nga xha Jahoja? Si

është? A mërzhitet? Ç'ka ndonjë nevojë? Doemos unë i shkoja vazhdimisht xha Jahos, jo vetëm si shok e mik të vjetër që e kisha, por edhe se zbatoja porosinë e posaçme të Partisë e të shokut Enver për atë luftëtar e atdhetar të shquar.

Një ditë xha Jahoja më mori në telefon (e mbante te koka telefonin), dhe më tha:

— Dua «Gazin», jo veturën, të ma dërgosh se kam një punë.

Ia dërgova menjëherë.

Xha Jahoja dërgon dhe merr me të dy dhi apo shqera në Kavajë dhe i bie në Tiranë, në shtëpinë e tij. Një ditë të diel ishim me shokun Enver dhe, si ngahera, kur më pyeti për xha Jahon, si është e si vete, ia thashë me lezet edhe punën e «Gazit». Shoku Enver qeshi dhe nuk tha gjë. Mbas nja dy muajsh, tek rrinim me një grup shokësh në shtëpinë e Partisë, thotë me humor:

— Në makinën e ministrit të Kontrollit hipin edhe bagëti! Shokët panë sho-shoqin. Unë rrija i heshtur. Shoku Enver prapë me shaka:

— Shiko, mos i presësh makinën xha Jahos ngaqë thashë unë ashtu!

Tunda kokën dhe iu përgjigja me buzëgaz:

— Unë i zbatoj urdhrat.

— Domethënë ta kemi bashkë përgjegjësinë, — tha shoku Enver me humor.

Dhe kështu vazhdoi interesimi e kujdesi i tij gjithë kohën sa qe gjallë xha Jahoja. Kur ky vdiq, shoku Enver shkoi pranë trupit të tij me nderim dhe, në një moment më tha:

— Ki kujdes, thuaju edhe shokëve që varri i xha Jahos të bëhet nga ana e shtetit sa më i mirë!

Edhe ministrat zunë të bënë stërvitje ushtarake. Në shtëpinë e Partisë shoku Enver më thotë:

— E, Shefqet, si shkoni në stërvitje?

— Mirë, shoku Enver.

— Besoj se ti nuk e ke vështirë, se je ushtarak. Por tani që je larguar, mirë të bën, të mos i harrosh rregullat ushtarake.

— Ashtu është, shoku Enver, mirë më bën.

— Pastaj tani duhen njohur mirë armët e reja, — vazhdoi shoku Enver, — se nesër, po të jetë nevoja, kalon nga ministër në ushtri. Apo jo?

— Mua më qajnë sytë për ushtri,
shoku Enver!

— Po, po, e di, prandaj dhe të them
që t'i mbani mirë armët e reja.

Jemi në festën e 24-vjetorit të Kongresit të Përmetit!

Kam shumë emocione e kujtime nga ky qytet. Këtu, veç të tjerash, u njoha nga afër me Komandantin e dashur, në majin e 1944-ës.

Midis kujtimeve të paharruara të atyre ditëve më vjen në mendje edhe ky episod:

Kisha një kalë të bardhë dhe në kohë të lirë dilja në një shesh aty afër dhe, si sevdalli i kuajve që isha, ia hipja dhe bëja stërvitje të ndryshme me të. E kishte parë atë kalë të bukur e energjik shoku Spiro Moisiu, i pëlqeu shumë dhe, meqenëse dhe ai ishte dashamir i kuajve, m'u

lut që t'ia falja. Më dhembti në shpirt kali, por nuk desha t'ia prishja qejfin shokut Spiro, ndaj, vërtet me zemër të thyer, ia dhashë fjalën se do të ta jap. Mirëpo këtë gjë, nëpërmjet shokut Hysni, e kishte marrë vesh edhe shoku Enver dhe në një nga ato ditë, kur po hanim drekë, vjen dhe më thotë:

— Si vete kali i bardhë, a bën stërvitje me të?

— Ia dhashë shokut Spiro Moisiu se ma kërkoi, — i thashë.

Shoku Enver duke qeshur më thotë:

— Jo, do ta mbash ti kalin se ti je kalorës dhe e ke merak. E porosita shokun Spiro që mos të ta marrë, — më thotë shoku Enver dhe më hodhi dorën në qafë.

U emocionova shumë, bile lashë dhe bukën, nuk më hahej më. M'u bë zemra mal jo për kalin, por për gjestin. Ja kush ishte Komandanti ynë i Përgjithshëm, udhëheqësi i dashur i Partisë, shoku Enver Hoxha! Në tërë ato hallë e punë të mëdha të asaj kohe historike kur drejtonte, veç të tjerash, punët e mëdha të Kongresit historik, gjente kohë e zgjidhte edhe çështje të tilla siç ishte ajo e kalit për mua!

Kanë shkuar 24 vjet nga ato ditë e tani kemi ardhur përsëri në Përmet, në festë.

Mbrëmja solemne organizohet në shtëpinë e kulturës të qytetit. Ndërtesa ishte e re, por jo dhe aq e mirë dhe brenda ishte vapë. Në një moment shoku Enver m'u drejtua:

— More Shefqet, më duket se ti je pak lokalist.

— Pse shoku Enver? — e pyeta.

— Sepse atë Tepelenën tënde e ndihmove ta bëjë shtëpinë e kulturës të mirë, kurse Lamçen (Sheme)* nuk e ndihmove!

— Shoku Enver, — i them po me të njëjtin ton humori. — Këta kanë deputetin e tyre, ai mund t'i ndihmonte.

— Po, po, e di atë, — ma ktheu, — por ti prapë s'del i larë. Si ministër i Kontrollit që je, duhet ta kontrolloje, ta shihje që s'i kishin mirë punët dhe t'i ndihmoje ta bënin më të bukur.

Ndërhyri një nga shokët:

— Do t'i japim fonde edhe Përmetit që ta bëjë më të mirë nga të Tepelenës.

Shoku Enver ia ktheu:

— Nuk e besoj, kjo punë ka nisur që në fillim «me hile». Shefqeti e la ta bënin kështu me qëllim që të mos ia shkonte Tepelenës!

*) Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Përmetit.

Të gjithë shokët qeshën.

Në të nesërmen shoku Enver më thotë:

— Do të shkojmë nga Tepelena, do të rrimë nja dy-tri orë.

Te shkallët e shtëpisë së kulturës bëjmë fotografi.

— Shoku Enver, — i thotë njëri. — Thuaj si të duash, por Shefqeti është i çelur kur vjen në Tepelenë.

— Ama ne do ia punojmë, — tha me të qeshur shoku Enver, — do të propozojmë ta heqim si deputet nga Tepelena, të mos e lëmë më këtu.

— Gati, shoku Enver, ushtar i Partisë, ku të më dërgoni!

— Po, po, veç kudo që të jesh, do ta mbash me hatër Tepelenën, — tha ai, dhe qeshën të gjithë.

Një herë shoku Enver shikon para Kryeministrisë, te Dega e Ankesave 4-5 njerëz ulur në shesh.

Më merr në telefon dhe më thotë:

— Pse rrinë e presin ata atje? Ç'an-kesa kanë? Më njoftoni!

Unë s'i kisha parë fare dhe menjëherë thirra kryetarin e Degës së Ankesave që t'i priste sa më parë dhe të më njoftonte ç'kishin. Por s'm'u prit dhe shkova edhe vetë, u dëgjova hallet. Kishin rregulluar punë diku në Tiranë, tani kërkonin pasaportizim e strehim. I dëgjova mirë e mirë, u thashë ç'kishin të drejtë e u takonte, por edhe ç'kishin gabim. M'u duk se u sqaruan e u bindën. E mora shokun Enver dhe e njoftova.

— Mirë, — më tha, — kështu duhera zgjidhur shpejt e gjer në fund ankesat e popullit, të mos presin me orë të tëra. Ata njerëzit që ke atje të punojnë më mirë dhe të rregulloni, gjithashtu, një dhomë për të pritur njerëzit, jo të presin në sokak.

Brenda dy-tri ditëve rregulluam një sallë pritjeje, por pyesja veten: «Pse vallë u desh ndërhyrja e shokut Enver edhe këtu? Pse nuk na u dha ta bënim më parë?!»

Vija nga Lushnja. Shoku Enver më pyeti për gjendjen e rrethit. I thashë se me transportin nuk janë mirë, nuk e përdorin transportin primitiv, si kafshë, qerre, karrro e të tjera. Mendjen e kanë te makinat.

Shoku Enver tundi kokën dhe më tha:

— Me rritjen që ka marrë bujqësia, transporti primitiv nuk mund t'i përballojë gjithë detyrat. Nuk them të mos i kushtojmë rëndësi, ai duhet e do të duhet sot e në të ardhmen në fushë e, sidomos në mal, në Kurvelesh e në Skrapar për shembull, megjithëse dhe atje, për pak vjet, do të duhet të hyjë gjerësisht transporti modern. Por pa e nënvleftësuar e lënë mënjane transportin primitiv, duhet menduar

më shumë për transportin modern; medoemos të shtojmë e të shfrytëzojmë sa më mirë makinat, zetorët, rimorkiot etj., për grumbullimin e drithërave të bukës e të perimeve në kohë rekord. Pajdje shokët e Lushnjës ma shtruan serioze çështjen e transportit të prodhimit dhe unë njoftova shokë të ushtrisë t'u japin një sasi makinash për të përballuar fushatën. Ne, — vazhdoi ai, — duhet të arrijmë që brenda 10 ditëve të mbjellim krejt sipërfaqen kur është koha e mbjelljeve dhe, gjithashtu, brenda 10 ditëve të korrim kur është koha e korrjeve. Po ashtu t'i heqim prodhimet nga arat, në kohë rekord. Kështu bëhet ekonomia.

Shkova në Vlorë për kontroll dhe nuk lashë gjë pa parë, me përjashtim të Fabrikës së Ekstrattaninit. Nuk vajta dot se nuk e duroja dot erën e saj, por më e keqja, nuk pyeta as shokët që kisha me vete për gjendjen e fabrikës.

Në Tiranë takova me shokun Enver dhe i fola për të gjitha ç'kisha parë.

— Po Fabrika e Ekstrattaninit është në rregull? Kam dëgjuar se kishte pasur avari? — më pyeti shoku Enver. Toni i tij ishte i qetë, por mua më ra si bombë.

Mbeta i hutuar, me gojë mbyllur. U preva.

— Nuk vajta, dhe nuk kam dijeni

për të, shoku Enver..., — munda t'i thosha, por sa shumë u dëshpërova!

Sigurisht, ai s'më tha asgjë, por unë s'lashë gjë pa i thënë vetes: kisha parë e kontrolluar gjithë ato objekte, gjer te spitali i njerëzve me të meta mendore dhe lashë mënjanë Fabrikën e Ekstratit, që është me aq rëndësi ekonomike! E prisha dasmën për një limon!

Në një takim të lirë shoku Enver më pyeti se si venë punët në Komisionin e Kontrollit. I thashë të miat. Ai, pasi më dëgjoi, më tha:

— Detyra e Komisionit të Kontrollit nuk është thjesht për të kapur njerëzit që gabojnë. Komisioni duhet të lërë kudo gjurmë ndihme e organizimi. Atje ku shkon Komisioni i Kontrollit, të ndihmojë, të mësojë njerëzit se si të punojnë e të mësojnë. Kjo do të bëjë që klasa punëtore t'i tregojë vetë ku i ka të metat në punë. Kështu të dyja palët do të mësojnë nga njëra-tjetra. Pra Kontrolli i Shtetit të ketë karakter sa më demokratik, me qëllim që punonjësit të njerëzit e kontrollit të mos

shohin frikën, por partishmërinë. Kështu duhet të punojnë njerëzit e kontrollit. I kam lexuar raportet tuaja, të mira janë, por në to duhet të vihen në dukje edhe anët e mira, jo gjithnjë të meta e të zeza. Shoket atje poshtë kanë edhe halle, shumë gjëra nuk u zgjidhen ashtu si duhet nga lart, se dhe këtu ka vështirësi e dobësi, edhe nga importi nuk vijnë me kohë materialet etj.

S'e harrova kurrë atë orientim.

U ktheva nga një inspektim në Tropojë dhe shoku Enver më pyeti për gjendjen e atjeshme. I tregova me kujdes. Mes të tjerash, i thashë:

— Në Dragobi, një plak i moshuar, mbi 90 vjeç. më dha të fala për Ju, por... ia kam harruar emrin.

Shoku Enver qeshi dhe më tha:

— Ka qenë filani?

— Po, — i thashë, — tamam ai ishte!

— Po, po, — vazhdoi ai, — jam takuar e kam bërë goxha muhabet me të kur kam qenë 10-13 vjet më parë në Tropojë.

U habita sa më s'ka: Edhe më 1953 unë e shoqëroja shokun Enver në Tropojë, por emrin e plakut nga Dragobia s'e mbaja mend jo më nga atëherë, por as nga 5-6 ditë më parë!

Shoku Enver më thirri në zyrë për një çështjen time personale dhe më këshilloi me durim se si ta kuptoja drejt. Unë me respektin më të madh e dëgjoja, por ngulja këmbë në kokëfortësinë time, veç gjithmonë me kujdes, me respekt e dashuri për shokun Enver. Tek e fundit shoku Enver me një ton dashamirësie, i imponuar nga kokëfortësia ime, më tha:

— Ti je një kokëderr që ngul këmbë në tënden! — dhe ma preku kokën me gishtin e'tij. Unë në atë kohë, si pa vetëdije, doja t'i puthja dorën shokut Enver, por ai nuk ma la. Qeshte me buzë në gaz:

— Duhet t'i kuptosh drejt edhe këto gjëra, Shefqet!

Për mua ishte një mësim i madh që shoku Enver kujdesohej edhe për punët e mia personale.

Do të më mbetet përherë në mendje!

Shoku Enver do të merrte takim me popullin e krahinës së Kardhiqit. Mbledhja do të bëhej te Rrapi i Picarit, në Gur të Koronit. Në mëngjes sa më pa, më pyeti:

— Do të shkojmë Shefqet?

— Si urdhëron, shoku Enver.

— Si është rruga?

— E mirë, — i them unë.

— Kush e di sa herë ke shkuar sonte natën për ta parë! — më tha buzagaz.

Unë qeshja: sikur më kishte parë! Shkuam në Picar, tek rrepet. Gjithë krahina ishte në gaz e hare.

Bisedon me Vehip Myrton nga Ma-

shkullora dhe me zor arrin të nxjerrë se uji akoma s'kishte shkuar në fshat.

— Shefqeti e ka fajin, — i tha duke qeshur.

— Vërtet, shoku Enver, — i tha Vehipi. — Ky më merr mënjane e më thotë të mos ju kërkohet gjë Juve.

Krisi gazi.

— Të zbulova! — më tha shoku Enver, dhe e mori për qafe xha Vehipin.

Jemi në Gurrë të Picarit, tek Rrepet e Buronje. Shokut Enver i pëlqeu shumë ky vend dhe tha:

— Këtu të bëhet një hotel i vogël dhe të ruhet mirë, të mos mërzejnë bagëtitë në këtë vend të bukur. Të bëhen dhe ura të vogla. rruga të asfaltohet, sepse do të vijnë nga qyteti për ta frekuentuar këtë vend të mrekullueshëm. Këtu të vijnë njerëzit për të ndenjur tre-katër orë ose edhe për të bërë piknik. — Heshti pak e vazhdoi:

— Mund të bëhet dhe festa e krahnës këtu.

— Shoku Enver, Kardhiqi e fshatrat

e tjera janë larg dhe nuk do ua ketë qejfi një punë të tillë, — i thashë.

— Këtë shikojeni, por vendi është shumë i mirë, unë mendoj se mund të bëhet, veç t'i vihemi! — tha ai.

Jemi në Gjirokastrë. Nisemi për në shtëpinë-muze, shtëpia e lindjes së shokut Enver. Kur do të hynim brenda, lagjja nëpër sokaqe, sofa e dritare shikonin shokun Enver me buzëgaz dhe ky i përshëndeste të gjithë me përzemërsi.

Brenda, në dhomën e zjarrit, që quhej dimërore dikur, ishte varur dhe fotografia e vëllait të tij, Beqirit, që kishte vdekur djalë i ri nga tuberkulozi në vitet e fukarallëkut të regjimit zogollian. Shoku Enver i mbante sytë herë-herë te fotografia, por pa e bërë veten. E vizituam shtëpinë në të tëra anët. Kur po bëheshim gati të dilnim, shoku Enver vazhdonte të na tregonte:

— Ja gryka e sternës dhe muslluku ku merrnim ujë, këtu ishte lavanterija. Kur na vinin gjitonët, hynin nga kjo derë, jo nga dera kryesore. Kur u dogj shtëpia, unë kam qenë shumë i vogël. Më mori aneja bran, se për pak u dogjëm brenda.

Na tregonte kështu me radhë e me hollësi me një lloj malli të thellë se si kishin qenë dhomat e miqve, të ndenjes, të grave etj.

Kur dolëm te dera, një grua e mo-shuar u lëshua ta përqaftonte. Shoku Enver aty për aty e pyeti për burrin.

— Ka vdekur të keqen, — i tha ajo.

— T'ju rrojnë fëmija, — e ngushëlloi shoku Enver duke i folur në emër, e duke kuituar se si vinin te hauri i sai. te fiku.

Shkova në shtëpinë e pritjes dhe e gjeta shokun Enver në tarracë. Fliste me një plakë aty afër.

— Si jeni nga Gjirokastra? — e pyeste shoku Enver e ajo i përgjigjej:

— Jemi mirë!

Këtë plakë nuk e njihja fare, por e dallova në dialekt se ishte labe. Asaj mezi i hapej goja nga emocioni, se si i flet Enver Hoxha që andej.

— Ne jemi fshatarë nga Kurveleshi, shoku Enver, — shtoi plaka.

— Shumë mirë, — i tha ai, — tani banoni këtu.

Unë nga prapa i fola:

— Janë nga Golemi.

Shoku Enver kthehet e më thotë:

— Kam dalë në tarracë, Shefqet, shikoj këto gërmadhat e vjetra. Duhet vënë dorë të mos i lëmë të bien, po t'i riparojmë mirë, pa u prishur formën dhe stilin, t'i rinovojmë. Brenda mund t'i ndreqim e t'i bëjmë apartamente, se kanë shumë volum. Ja, si e kanë ndrequr dhe pazarin, më pëlqen. E kanë bërë mirë.

— Kështu duhet, shoku Enver, edhe sheshi i Çerçizit mund të zgjerohet, — i thashë.

Qeshi dhe më tha:

— Propozimi juaj në Qeveri disa vjet më parë, që të bëhej me tarracë sheshi dhe përposh tregu, ishte i drejtë, po aherë ishim ekonomikisht ngushtë, sepse duhej hekur e të tjera mjete, dhe ta hodhëm poshtë propozimin që bëre.

— Po unë, shoku Enver, në atë mendje jam dhe për tani.

— Mirë, mirë, po aty janë bërë binara! — tha shoku Enver, — dhe vazhdoi bisedën me plakën nga Golemi që fluturonte nga gëzimi, nga fjalët e ngrohta të shokut Enver që mbante mend edhe hollësi të tilla.

Në Gjirokastër, në shtëpinë e Sherif Zenelit, mëma e Asimit dhe e Sherifit, një grua plakë, e pret shokun Enver me duar hapur, si labet. Shoku Enver e pyet për gjendjen shëndetësore, ekonomike e të tjera halle dhe ajo i thotë:

— Gjendja është shumë e mirë, edhe shëndeti, çka, si plakë që jam.

Shoku Enver i thotë:

— A të kthehen këta shokët për vizitë kur vijnë këtu në Gjirokastër? — dhe tregoi nga unë. Ajo i thotë:

— Shefaeti më vjen, po këta të vendit jo shumë herë! Nuk u vë faj se kanë dhe punë...

— Jo, — i thotë shoku Enver, — du-

het të gjejnë kohë për të ardhur, sado punë që të kenë.

— Të keqen unë, more Enver, — i tha plaka pastaj, — po të bënin të gjitha mizat mjaltë, h a n ë dhe ata që s'kanë bletë.

Shoku Enver qeshi. Kur u larguam që andej, ajo mezi ia hoqi duart nga qafa. Shoku Enver u kthye nga unë dhe më tha:

— Shumë mirë bën që kur vjen në Gjirokastër, viziton edhe plakën që gëzohet shumë. Ka rritur dy shokë të mirë që nuk janë më. Është nëna e Asimit, nënë heroi!

Kalojmë shëtitje në Qafë të Pazarit. Shikojmë dyqanet që janë rregulluar. Shkon një jevgjit aty pranë. Shoku Enver e njeh, e mbante mend që kur ishte i ri dhe i bëri shenjë të afrohet, i flet, e përqafton. Atij i ndritën sytë nga gëzimi, i lëshohet në krahë shokut Enver dhe e puth. Shoku Enver vazhdon ta përgëzojë, bisedon me të për fëmijërinë, e pyet për jetën e tij, si rronte, si ishte nga gjendja ekonomike, a kishte ndonjë ankesë, e të tjera, e të tjera. Jevgu ca nga gëzimi, ca ngaqë kishte kthyer ndonjë kupë, rri një çikë, e hop për qafe shokun Enver. Ne nuk e duronim dot atë përqaftim, po shoku Enver i hapte vetë bisedë dhe s'po e linte të shkonte. Fshehur,

që të mos më shikonte shoku Enver, mundohesha t'ia bëja nga pas me shenjë jevgut që të largohet. Mirëpo më kot, atij s'i mbushej mendja. Plasa nga inati.

Kur vëmë në shtëpi, shoku Enver duke qeshur më tha:

— Ama ti Shefqet, sikur je mërzhitur pak.

— Jo, shoku Enver, pse?

— Po me isharet pse ia bëje, dhe kujt ia bëje? — dhe qeshte. E kuptova, më kishte parë.

— Shefqet, mos je racist, mos je kundër zezakëve? — vazhdonte të më shponte.

— Jo, sigurisht nuk jam kundër, — i thosha. — Ai shoku juaj i fëmijërisë, burrë i mirë dukej, po ishte i papastër laneti.

— Nuk është faji i atij. Fundja duhet edukuar.

— Po moshë e madhe, shoku Enver, ç't'i edukosh tani.

— S'ka gjë, edhe moshat e mëdha edukohen, se u pëlqen radioja, televizioni, teatri etj., etj.

Ktheheshim nga shtëpia-muze e shokut Enver dhe në krye të rrugës që zbret për në Varosh, aty afër Komitetit Ekzekutiv të sotëm, shoku Enver ndali (ishim më këmbë) dhe tha:

— Këtu në këtë vend ishte një sofa para një dyqani, ku rrinte Vehip Qorri, një i verbër. Kur i flisje, ai menjëherë të fliste në emër, se të njihte nga zëri. Më të shumtat e herës të përgjigjej me vargje, se ishte bejtexhi shumë i mirë. Po t'i thoshe: «Bjeri culës», ai ia fillonte dhe i binte aq mirë! Më kujtohet, ky Vehipi ishte nga Gusmari i Kurveleshit, në mos nga Golemi.

— Po, shoku Enver, — i them unë. —

Dhe unë e kam njohur, andej ishte, po pse rrinte këtu, në këtë vend?

— Sepse këtej nga Varoshi ishte rru-
ga nga vinin kurveleshasit në pazar të Gji-
rokastrës dhe Vehipi, donte të mbante li-
dhje me ta. Nxirrte mallin e dhembshurinë
e vendlindjes. Varfëria e kishte detyruar
atë të linte vendin, se ishte pa sy, dhe këtu
i jepnin lëmoshë ata që donin të dëgjonin
culën ose bejtet e tij. Cula dhe vjershat e
ushqenin Vehipin.

Gjatë ditëve që qëndruam në Gjirkastër, në shtëpinë e kulturës do të jepej një koncert.

U morëm vesh qysh më parë me shokun Rrapo Dervishi, sekretar i parë i rrethit, që koncerti të mos ishte më i gjatë nga një orë, e shumta një e ca, se bënte dhe shumë vapë. Na siguruan se kështu do të vepronin.

Kur do të hynim, më pyeti shoku Enver:

— E, mor Shefqet, sa do të jetë?

— Një orë, shoku Enver.

— Ta hodhën! — më tha.

— Jo, shoku Enver, një orë.

— Ja po të them unë, — tha ai, — 2 orë do të vejë se s'bën.

Unë mënjanë u thashë edhe një herë shokëve të rrethit të kishin kujdes që të mos e zgjatnin shumë. Ata përsëri më siguruan. Kur shkuam në koncert, vapa qe shumë e rëndë, sepse salla ishte pa ajrim. Shikoja orën dhe kur ajo kaloi, shoku Enver më shihte buzëgaz. Isha bërë prush. Edhe shoqja Nexhmije qeshte, se doemos, e dinte ç'qe «njëorëshi» i gjirokastritëve. Fillova të lëviz, nuk më mbante vendi. Shkoi një orë e gjysmë, dhe koncerti s'mbaronte, po bëhej dava Janine. Shoku Enver, megjithëse vapë, qëndronte i qetë, kurse unë lashë koncertin fare se hahesha nën zë me kryetarin, Subi Bakirin. Por shoku Enver na vënkej veshin me buzëgaz, sado që ne ruheshim me shumë kujdes.

Kur dolëm jashtë, duke qeshur e me humor i thotë Subiut:

— Ama, ç'ia bëre mirë shokut Shefqet! I thatë një orë, por ju e dinit që do të shkonte dy!

— S'kanë disiplinë, shoku Enver, — i thashë.

— Unë nuk them se s'kanë disiplinë, — tha shoku Enver. — Ata dy orë e kishin vendosur që në fillim, po të bënë qejfin ty, të thanë një orë, se gjenin belanë! — dhe ia dha i pari të qeshurit.

Jemi në shtëpinë-muze të Topullarëve. Si mbaruam së vizituar, dolëm te shkalla.

— Hajdeni të bëjmë një fotografi këtu te shtëpia e Topullarëve, se ishin luftëtarë të' shquar të Rilindjes! — na thotë shoku Enver e pastaj, i menduar shtoi: — Kush e di se kur vijmë prapë!

Na erdhi edhe mirë, për fotografinë që do të bënim, por edhe na prekën fjalët e fundit të tij. Ndërkohë ai sodiste vendin e tha:

— Si na duken këto rrugët e Gjirokastrës, sikur janë të shtruar me sixhade! Apo jo Shefqet, — m'u kthye mua, — shikoje Picarin e Çelos përkarshi! Të qan

zemra, e di. E mora vesh që ti ike natën dhe vajte more pjesë në festën e ardhjes së ujit në Picar, sado që është larg kanali, nëpër male.

— Picari i Çelos, shoku Enver, — i them, — por ujët s'e shpuri dot i ziu Çelo. E shpuri Partia.

Nuk foli, buzëqeshi. Unë vazhdova:

— Shoku Enver, është bërë një çezmë atje në Picar dhe vjen ujë boll!

— Si quhet vendi ku merret ujët? — më pyeti.

— Kulpëri i Kolonjës, është 6 kilometra larg.

— Mirë, mirë, bukuri, ta gëzojë populli! — tha me zë të butë e të ngrohtë.

Kur zbrisnim nga Libohova, në fushën e Dropullit, disa gra, në arat pranë rrugës, lanë punën dhe iu lëshuan makinës së shokut Enver. Një nga ato i tha:

— Pu ise, mori shoku Enveri! — dhe iu hodnën për qafe. Shoku Enver i pyet si ishin me punë, me drita, me ujë etj.

— Me ju e me Partinë nuk kemi qenë kurrë keq! — i përgjigjeshin ato. — Më mirë se sot, o shoku Enver, nuk kemi qenë, ndaj t'ju bëhet dita një mijë! — e plot urime të tjera.

Shoqëroj shokun Enver te lapidari i Çerçizit në Mashkullorë. Aty kanë ardhur gjithë mashkulloritët. Atdhetari Vehip Myrtoja tregon se ku e qysh luftoi Çerçizi me shokë. Shoku Enver e dëgjonte dhe, midis të tjerash, tha:

— Xha Vehip, këto kodra të bukura, që Çerçizi me shokë i mbronte nga turqit, sot duhet t'i zbukurojmë. Jo të mbeten me driza, po të mbushen me frutikulturë, të mbillen dhe të bëheri të lulëzuara.

— Po, shoku Enver, do t'i bëjmë, — i thotë xha Vehipi, — por ama të japë urdhër Shefqeti të na bjerë ujët.

Shoku Enver u kthye nga unë:

— T'u qep xha Vehipi dhe nuk të

ndahet; tani ti e di se ç'do të bësh me të.

Qeshën të gjithë të pranishmit. Populli e vuri në mes shokun Enver dhe nuk e lëshonte, kush e kush t'i rrinte më pranë. Të gjithë ishin të gëzuar, burra, gra e fëmijë, dhe shoku Enver nuk linte njeri pa i dhënë dorën me përzemërsi të madhe. Kur vajtëm në shtëpi na tha:

— Njëqind herë të vdesësh e të lindësh për këtë popull, ia vlen të punosh! Kemi popull të mrekullueshëm!

Një ditë më pyeti shoku Enver:

— Kur shkruan, a i mban dorëshkrimet ti Shefqet?

Unë i them:

— Jo, shoku Enver, mbasi i shtyp në makinë, i gris.

— Nuk bën mirë, — më tha. — Ato kanë vlerën e tyre, prandaj duhen mbajtur!

Nuk i tregova që unë s'i mbaja sepse s'kam as shkrim të bukur, por shoku Enver, duket, më kuptoi vetë pa ia thënë unë, dhe ma priti:

— Sido që të jetë shkrimi, s'ka rëndësi kaligrafia. Puna është te përmbajtja dhe te përshtypja që lë shkrimi yt i dorës.

Më mbuluan djersët. Prej asaj dite kam filluar të mbaj disa dorëshkrime të dorës sime, sidomos, kur jam në humor që shkruaj ngadalë e disi mirë, dhe jo shkarravina, siç më ndodh kur nxitohem, aq sa më vonë s'e këndoj dot as vetë atë që kam shkruar.

Jemi në Fier. U vendos që shoku Enver do të shkonte në Visokë, në një zonë nafte. Në makinën e shokut Enver hipi edhe sekretari i partisë i rrethit Lamçe Sheme. Duke udhëtuar, ai, siç duket u hutua dhe nuk e ndali makinën në Visokë, por mori udhën për në Ballsh. Shoku Enver i thotë:

— More Lamçe, sikur nuk jemi mirë.

— Jo, mirë jemi, shoku Enver, — i tha i emocionuar. Ne nga mbrapa u shqetësuam, por si të bënim, thamë mos kanë vendosur të venë në Ballsh, dhe udhëtonim pas tyre.

Më në fund drejtori i naftës u doli me «Gaz» përpara dhe u thotë:

— Visoka mbeti prapa!

Shoku Enver buzëgaz u kthye, por na pa ne që ishim bërë helm të mërzitur, dhe me buzë në gaz për të na qetësuar, tha:

— Bëmë një shëtitje me Lamçen, jo se harruam Visokën! Pastaj duke qeshur m'u dretjua mua:

— Ama, hakçe, ti Shefqet e ke fajin, nuk e ka Lamçja!

Jemi në Tepelenë. Shoku Enver do të flejë në shtëpinë e pritjes, e cila nuk ishte e përshtatshme. Nuk më mbante vendi, po shoku Enver nuk pyeste fare asaj ane. Në mëngjes, kur u takuam e pyeta si kishte fjetur.

— Shumë mirë, — tha ai i qetë. — Këtu është tamam shtëpi pushimi.

Shokët e rrethit u kënaqën nga ato që dëgjuan, po unë jo; nuk më besohej kënaqësia e tij. Mbas disa minutash shoku Enver tha:

— Në katund duhen qentë, por në qytet s'di pse duhen!

Akoma më qartë e kuptova se sa «mirë» kishte fjetur!

Kur po largoheshim nga Tepelena shoku Enver takoi me Riza Veipin dhe, mes të tjerash, i thotë:

— E, more Riza, i kam thënë Shefqetit që jemi borxhlinj për krahinën e Kardhiqit, se nuk kemi ardhur. Tani po e shtojmë akoma më tepër borxhin...

— Ju pritëm kur ishit herën tjetër në Gjirokastër, — i tha xha Rizai, — por ju e mbani mend si ndodhi: u prish koha dhe s'deshët që të lagej populli, ndaj e anuluan vizitën. Të gjithëve u mbeti në zemër kujdesja juaj, por, kur morëm vesh arsyen pse s'erdhët, njerëzia thoshin: «Jo shi, por dhe gurë të binin nga qielli, ne do të dilnim». Por mos u bëni fare merak, populli është për bukuri, Ju shikoni shëndetin e punët, pa do të vijë dita të vini edhe te ne në Kardhiq.

Midis të tjerash, në Tepelenë shoku Enver bëri homazhe në Varrezat e Dëshmorëve (të vjetrat) dhe kur po zbrisnim në qytet më tha:

— Duhet të merren masa sa më parë që varret e dëshmorëve të bëhen të mira, jo kështu. Të bëhen me gurë mermeri dhe jo mermer që të priset shpejt, por gurë mermeri që të jetojnë me shekuj, sepse këtu prehen dëshmorët e Luftës Nacionalçlirimtare që do mbeten të pavdekshëm

me shekuj. Të mos kursejmë asgjë për varret e tyre dhe jo vetëm këtu, por në gjithë Republikën tonë Popullore.

Pastaj filloi të më japë udhëzime e porosi që Komisioni i Kontrollit të Shtetit të ushtrojë kontroll në të gjitha rrethet që varrezat të bëhen kudo sa më parë dhe sa më mirë. Dhe ashtu u bë.

Jemi në Gjirokastër dhe shkojmë për në shtëpinë e pritjes. Te një rrugë e ngushtë i them kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit:

— Ja, këtu mund të zgjerohet rruga.
Shoku Enver ndërhyri:

— Jo, po u zgjerua kjo pjesa këtu, e humbi lezetin dhe origjinalitetin. Ne duhet ta mbajmë Gjirokastrën siç kemi vendosur, qytet-muze. Shtëpitë dhe rrugët e reja të ndërtohen poshtë, për shembull nga stadiumi, ai'ër bregut të ish-teqesë. Mund ta kenë koston pak më të lartë, por aty bëhet shumë e bukur. Kur shkuam në shtëpinë e re të pritjes, shoku Enver foli prapë për ruajtjen e qytetit-muze.

— Ja, — tha, — sa keq janë bërë ca shkolla e shtëpi të reja, që nuk janë në harmoni me pamjen karakteristike të qytetit; — dhe dha porosi që shokët të kenë kujdes në këtë drejtim.

Nga Tepelena nisemi për në Gjiroka-
stër me shokun Enver dhe shoqen Nexhmi-
je. Në Ujët e Ftohtë ndalemi për drekë.
Shokët e rrethit kanë përgatitur aty diçka
për të ngrënë, ndërmjet të tjerave dhe ca
bukë të misërt. Shoku Enver e vë re që
unë nuk marr bukë të misërt dhe, duke di-
tur që unë e dua atë, më thotë:

— Pse nuk ha bukë misri ti, Shefqet,
apo s'e pëlqen? Po i fyen këta shokët që e
kanë prurë! — Pastaj duke qeshur vazh-
doi: — Apo mos e do të jetë si buka e
Sheros...

— Jo, shoku Enver, por është bërë
me ujë të ftohtë dhe është e fortë.

— Prandaj të thashë dhe unë që ty

s'të pëlqen, — më tha shoku Enver. — Do të jetë e furrës në seri. Nuk është bukë nikoqireje e bërë në saç.

Shoqja Nexhmije ndërhyri duke thënë:

— Nuk është e keqe, është e mirë.

E kishte hallin se mos turpëroheshin shokët që e prunë.

— E mirë, e mirë, — ia ktheu shoku Enver, — por ju nuk hëngrët që ta provonit...

Të gjithë ia shkulën gazit.

Midis të pranishmëve në këtë drekë janë dhe disa të moshuar, si Kalo Ibrahim, pensionistë e të tjerë. Shoku Enver këtyre njerëzve u flet me emër e i afron me përzemërsi. Ata rrëmbehen nga gëzimi. Dreka kalon në atmosferë gëzimi e hareje të veçantë.

Mbas nja dy vjetëve shoku Enver më thotë:

— More Shefqet, rrojnë filani e filani (me emër), ata të moshuarit që ishin për drekë dy vjet më parë në Ujët e Ftohtë?

U zura gafil. Le që nuk dija nëse rronin apo jo, por disave s'ua mbaja mend as emrat.

Jemi në Libohovë, te Rrapi. Zura një vend në fund të tavolinës, por shoku Enver më thotë:

— Hajde më lart, se këtu jemi mysafirë. Libohovitët janë hanedanë, do të na japin edhe kafe..., apo jo?

— Po, shoku Enver, do të na japin!

— Ju nga jeni? — pyeti kryetarin e lokalitetit.

— Këtu, nga vendi jam, shoku Enver.

— Shumë mirë, — i tha.

— Por kam qenë në Tiranë me shërbim, dhe kam ca kohë që kam ardhur. Atje kam punuar në Komisionin e Kontrollit.

— Aa! Prandaj Shefqeti s'po bën asnjë vërejtje për ndonjë të metë, se ju pas-

ka të tijtë. Të ka pasur në sektorin e tij dhe ka frikë se turpërohet vetë! — i tha shoku Enver duke qeshur.

Në këtë kohë vjen një plakë, nënë e një shoku, dhe i lëshohet shokut Enver për qafe. Ky e merr aty afër dhe i thotë:

— Djalin e ke mirë dhe po të duash t'i shkruash ndonjë letër, bëje dhe ia japim ne.

Nëna, që s'mbahej nga gëzimi, nuk dinte se ç'të bënte, me fjalët e urimet më të mira. Pas ca shkuam në shtëpinë-muze të Avni Rustemit. Aty shoku Enver bëri vërejtje e porositi që të pasurohej e të ruhej sa më mirë ky objekt. Kur e kishim plotësuar programin, e pyetëm:

— Do të largohemi, shoku Enver?

— Prisni, — na tha, — kemi lënë fjalë me plakën që do të na bjerë letrën për të birin.

— Lëmë njeri të na e bjerë, — i thashë.

— Jo, — tha shoku Enver, — do ta presim! Pas pak doli plaka me letër në dorë dhe iu drejtua shokut Enver. I dola përpara t'ia merrja, por plaka desh t'ia jepte shokut Enver në dorë. Ai e përqafoi nënën, i la shëndetin dhe i tha të mos kishte merak, se do t'ia jepte letrën djalit në dorë sapo të mbërrinim në Tiranë.

Më thërret shoku Enver dhe më porositi t'u them shokëve të pushtetit në Fier që të kenë kujdes, të mos e presin pyllin e Levanit, në luginë.

— Disa nga shokët e rretheve, — vazhdoi ai, — tani kanë mani t'i shfarosin pyjet për të hapur toka të reja pa bërë asnjë diferencim. Kjo s'duhet lejuar. Ka sipërfaqe me shkurre që duhen shkukur e të hapen toka buke, por ka edhe sipërfaqe me drurë pyjorë që janë me vlerë, që nuk duhet të priten, përkundrazi, të pastrohen e të mbrohen.

E çova në vend menjëherë porosinë që më dha, dhe shokët e Fierit morën masa. Por me kohë ata u transferuan në de-

tyra e rrethe të tjera, u zëvendësuan nga shokë të tjerë. Nga merakuri se mos edhe këta i binin pyllit, ua transmetova porosinë e shokut Enver dhe mendova se kjo punë tani ishte vënë në vijë. Kaluan vite dhe një ditë, duke kaluar për në Vlorë, sa u futa në luginën e Levanit m'u drodh trupi.

Shikoj që nga fundi, si me lezet, kishin filluar traktorët të hynin në pyll. M'u desh të ndërhyja menjëherë dhe, kur pyeta se pse ishte shkelur porosia, shokët mblodhën supet: s'dinin gjë për të! Qenkëshin të rinj, kishin zëvendësuar të mëparshmit. Ishte dhe për të qeshur dhe për të britur! Ia tregova shokut Enver historinë dhe ai i vrenjtur tha:

— Shokët e rinj mund të mos e dinin vërtet porosinë konkrete për pyllin e Levanit, por orientimet e direktivat e Partisë e të pushtetit për pyjet duhet t'i dinë patjetër.

Pas Kongresit të 5-të të Partisë më thirri shoku Enver e më porositi të shkoja në Kurvelesh dhe t'u thosha që të mbjellin të gjitha fshatrat patate, të paktën nga 10 hektarë, se patatja, përveç që ishte bukë, por ishte edhe gjëllë. Shkova, por hajde t'u mbushje mendjen fshatarëve të Kurveleshit se edhe atje bëhej patatja! Sipas tyre s'bëhej që s'bëhej. Kur e pashë se s'dilej ndryshe shkova fshat më fshat të Kurveleshit të Sipërm dhe u thashë vetëm dy fjalë:

— Shoku Enver më porositi të vij te ju t'ju them për patatet!

— Meqë është fjala e Enver Hoxhës,

ne do të bëjmë ç'është e mundur që ta mbjellim! — m'u përgjigjën kudo.

Fjala u bë realitet. Pataten e mbollën jo në 10 hektarë, por edhe në 15, e dha prodhim për bukuri. Mirëpo tregtia nuk ishte e përgatitur që t'ua merrte prodhimin e tepërt që dhe ata t'ia ndienin fitimin kësaj bime e të mbillnin prapë.

Fajin s'e ka toka, po koka.

Shokut Enver i kishte vdekur një motër dhe shkova për ngushëllim me nja dy shokë.

Na priti siç priste ai, e, edhe pse ishte i dëshpëruar, nuk e bënte veten, donte të na bënte muhabet.

Pas karriges ku isha ulur unë, ishte një kanarinë që këndonte shumë bukur. Si me lezet dhe për t'i dhënë ngjyrë tjetër ambientit, ktheva kokën ta shihja.

Shoku Enver më ndoqi e më tha me një buzëqeshje të lehtë:

— E kam shumë llafazane. Kur i vete unë pranë, fillon të qaset tek kuvlija; kur ia bëj me dorë, e afron sqepin afër telit! Ama, kur shkon Nexhmija, ikën e s'i afro-

het. Si duket trembet, — dhe qeshi. Afrova dorën te kuvlija dhe kanarina zgjati sqepin.

— Çudi, — thashë, — zogu m'u afrua edhe mua që jam ushtarak e më mbajnë për të sertë.

Një mbrëmje shoku Enver thirri në shtëpinë e tij shumë shokë me gjithë familjet për darkë. Mua më ngarkoi detyrën e dollibashit.

— Ju lutem, shoku Enver, mos më turpëroni! — i thashë.

— Përkundrazi, — ma ktheu, — të vë të drejtosh rakinë.

Desha s'desha, e pranova dhe fillova dollinë duke ua dhënë shokëve me radhë. Ata që s'donin. doemos ngulja këmbë ta pinin, se dhe shoku Enver ma jepte pëlqimin, më inkurajonte. Ç'muhabet i përziemërt, i ngrohtë! Lezetin kryesor ia jepte shoku Enver.

Dollinë e parë e pinë të gjithë. Shoku Enver më drejtohet mua:

— Nuk je dollibash i mirë e i prerë, siç mendonim, Shefqet, sepse mua nuk më gjete, s'ma dhe dollinë.

Krisi gazi.

— S'desha vetë, se të ruajta, — i thashë.

— Jo, — tha ai, — zakonet janë zakone!

Aherë unë ia dhashë dhe shokut Enver. Ai ngrihet në këmbë simbas rregullit, i ngre një për një dollitë, duke i përcjellë me buzë në gaz. Ora kalon nga 11 e natës, erdhi çasti të shpërndaheshim. Shoku Enver del te dera të na përcjellë. Shoqët më shtynin mua të dilja përpara. Unë u thosha shoqeve:

— Shkoni ju përpara!

Shoku Enver dëgjonte dhe rrinte më këmbë, priste. Shoqet nuk pranonin të dilnin para nesh. U them prapë:

— Shkoni, moj shoqeni, se këtë privilegj ua dha ky, — tregova shokun Enver, — se të qe për mua, s'jua jepja kurrë.

Krisi prapë gazi, shoku Enver qeshte me të madhe. Shoqet thanë:

— E dimë dhe vetë këtë punë, Shefqet, që nga ti s'prisnim gjë!

Të tillë ngrohtësi dhe unitet në Partinë tonë ka krijuar shoku Enver, zemra e tij behar, që di kur kërkon llogari për punë, dhe di kur bën humor e gëzim me secilin e me të gjithë bashkë.

Shoku Enver kishte marrë vesh se xha Vehip Myrtoja nga Mashkullora kishte dy vasha të emëruara në Kukës. Më thërret një ditë e më tha:

— Xha Vehipi tani është plak, thua-ju shokëve të Kukësit të gjejnë mundësinë e t'ia çojnë në Gjirokastër vajzat se i ka larg. E çova porosinë e tij, por vashat vonuan.

Ndërkohë shoku Enver shkoi për vizitë në Kukës. Nuk harroi e pyeti për to dhe i thanë se nuk ishin transferuar akoma.

Kur kthehej nga Kukësi për Tiranë, shoku Enver qëndroi te buronja në Mal të Bardhë. Për çudi, aty shikon xha Vehipin

në autobus që shkonte për Kukës dhe e thërret pranë. E përgëzon, e pyet për shëndetin. Më në fund i thotë duke i shkelur synë:

— Ama, ai Shefqeti e mbaroi porosinë që i dhamë për transferimin e çupave!

— E poqa Shefqetin dhe dje, — i thotë xha Vehipi. — dhe nuk duaj që të më linte të vija në Kukës, «Do të transferohen», më thoshte. Tani e marr vesh pse s'desh të më lërë!

— E ke dhe kundërshtar si duket! — i thotë shoku Enver duke qeshur.

— Po, shoku Enver, nganjëherë çoku më thotë dhe matuf.

Shoku Enver, kur kthehet në Tiranë, më takon e më thotë:

— Poqa xha Vehipin që shkonte në Kukës, dhe m'u ankua për ty.

— E di, e di, — i thashë, — se kur unis për Kukës tek unë fjeti.

Qeshëm me të madhe.

Më takon shoku Enver e më thotë:

— Kur kthehesha për në Tiranë, ndalova në fushë të Picarit, te një arë ku punonin shumë shoqe. Fola me to e i pyeta: «A ju ka ardhur Shefqeti ndonjëherë»? Ato m'u ankuan, më thanë «ka shumë kohë, bile vite, që nuk ka ardhur». Ndaj ti Shefqet duhet të vesh.

I mora të vërteta këto fjalë të shokut Enver dhe nuk vonova e shkova në fshat, bile para popullit përmenda dhe atë që më tha shoku Enver, domethënë bëra autokritikë. Një grua fshatare më tha: — Rroftë sa malet shoku Enver që, me gjithë punën e madhe të Partisë e të Qe-

verisë, mendon dhe për dëshirat tona, që duam t'u shohëm edhe juve të na vini! Ju harroni, sepse keni edhe punë, por s'ju lë ditëgjati të harroni, ai ju heq veshin që të kujtoshi...

Kur u ktheva, ia thashë shokut Enver këto gjëra. Qeshi dhe më tha:

— Ishte e mirë kritika që të bëra; vajte dhe tani besoj do të vesh herë pas here. Mos harro, — më tha shoku Enver, — se do më ankohen prapë ato gra!

Në të vërtetë asnjëra s'ishte ankuar, po shoku Enver e dinte që unë s'kisha vajtur, ndaj më tha me lezet sa më shpuri.

Në Hundëkuq të Gjirokastrës vate ujët për të cilin kishin vuajtur me shekuj. Gëzim i madh. Atë ditë edhe pleqtë kënduan e hodhën valle. Më thirri shoku Enver e më pyeti:

— Ishe në Hundëkuq?

— Isha, shoku Enver.

— Sa çezma u bënë?

— Tetë.

— Nga e muar ujin?

— Nga Labova.

— Me ç'tuba?

— Me tuba gresi, të prodhuara në Vlorë.

— Shumë mirë, sa kilometra?

— Gati 2 km.

— A u gëzua populli?

— U çmendën nga gëzimi.

— A ka ujë shumë?

— Shoku Enver, duhet ndihmuar që ky ujë të mos vejë dëm, po të bëhet ndonjë rezervuar për të ndihmuar ujitjen.

— Duhet parë që t'u japim ujë gjithë fshatrave që s'kanë dhe ato tubat e Vlorës të jenë me rezistencë më të fortë... Sa të bëjmë metalurgjinë në Elbasan, pastaj e zgjidhim problemin. Po në Picar nga u muar ujët?

— Nga Kulpëri, ujë shumë i mirë.

— I mirë është, po rreth 6 kilometra larg, — më thotë.

— Është dhe terren i vështirë, veç ndihmoi ushtria shumë.

— Po me ç'tubacion?

— Janë tuba çeliku, 100-polshe.

— Sa ujë sillet?

— Deri 5 litra në sekondë...

Është e tepërt të shpjegosh domethënien e dialogëve të tillë të hollësishtëm të shokut Enver edhe për gjëra kaq të imëta.

Ishim në Labinot, në shtëpinë-muze ku gjatë Luftës janë zhvilluar mbledhje e konferenca të rëndësishme. Te hyrja ishte libri i përshtypjeve dhe të gjithë e kishim syrin te shoku Enver. Shoku Enver i thotë shokut Ramiz:

— Shkruaj ti për të gjithë ne, Ramiz!

— Jo! — tha ai buzëgaz. Atëhere shoku Enver m'u drejtua mua:

— Shkruaj ti, Shefqet!

— Jo, shoku Enver, këtu ka njerëz të kalemit, — i them.

— Po edhe ti je i kalemit, — ma priti shoku Enver. — Pse e përjashton veten, ti ke bërë libra!

Nuk fola, po sikur nuk desha të ma thoshte në sy të të tjerëve këtë gjë.

Shoku Enver, e kuptoi që u preka,
erdhi afër meje, si rastësisht, më mori për
krahu e dolëm në fotografi.

Jemi në Durrës me pushime. Shoku Enver një mëngjes, pasi u rrua e i la brisqet te vendi, pa punëtoeren që pastronte, tek e hodhi në shportë briskun e përdorur. E porositi që të mos e hidhte më poshtë, gjersa një herë qe rruar me të. Mirëpo punëtorja edhe të nesërmen prapë e hodhi në shportë briskun. Shoku Enver u nxeh dhe i tha:

— Unë do të rruhem aq herë sa rruhen edhe punëtorët me këto brisqe, prandaj nuk duhet të ma hedhësh më në shportë!

Ma tregoi këtë gjë, në një nga ato ditë dhe më pyeti:

— Ti, Shefqet, me ç'brisqe rruhesh?

— Me këta të rinjtë, që kanë dalë tashti, — i thashë.

— Sa herë rruhesh me to? — më pyeti.

— Ka raste edhe 6-7 herë, shoku Enver.

— Po a i fshin?

— I fshij!

— Jo. — më tha, — nuk duhen fshirë, se po t'i fshish, prishen. Duhet t'i lash me ujë dhe t'i shkundësh pa i fshirë, ashtu e kanë rregullin. Ashtu mund të rruhesh edhe 10 herë me një brisk...

Shoku Enver më pyeti se ç'mendim kisha e përse ndodhi ngjarja e hidhur në Tepelenë me sekretarin e Komitetit të Rinisë dhe një shoqe të rinisë.

I thashë se sekretari i rinisë nuk veproi mirë.

— Po, po, e di që s'veproi mirë, po ç'e shtyu të vepronte kështu? Cilat ishin shkaqet që i detyruan të dy të rinjtë të arrinin në atë përfundim?

Nuk isha në gjendje t'i përgjigjesha. Isha nervoz.

U thirra në Komitetin Qendror për t'u vënë në dijeni, si deputet i krahinës, të lexoja gjithë praktikën rreth asaj ngjarjeje. Në një nga ato ditë më takoi shoku Enver:

— I lexove? — më pyeti.

— Po, shoku Enver, i lexova, tani e kam të qartë...

Shoku Enver më tha:

— Mëthetëthashet i detyruan ata të vepronin ashtu siç vepruan. Veprimi i tyre është i dënueshëm, nuk duhet të vepronjë kështu të rinjtë, po fajtorë s'ishin vetëm ata. Mëthetëthashet bëhen pengesë për vajzën labe të marrë pjesë gjallërisht në jetë, prandaj duhen dënuar rreptë...

Të nesërmen doli në buletin fjala e shokut Enver për atë ngjarje...

Isha porositur nga mjekët të mos bëja banja dielli në plazh dhe të mos futesha në det asnjëherë. Dhe unë ashtu veproja.

Një ditë shoku Enver më pyet:

— More Shefqet, s'të kam parë asnjëherë të lahesh në det. Pse nuk lahesh?

— E kam të ndaluar, shoku Enver.

— Pse e ke të ndaluar?

— Se vuaj nga reumatizma dhe nga ca zmadhim zemre. Më kanë këshilluar doktorët.

— Po mirë, ç'kura bën?

— Shkoj në llixha, në Peshkopi.

— A të kanë bërë efekt?

— Jo, — thashë, — s'më kanë bërë mirë.

— Sa vjet ke që vete?

— 7-8 vjet.

— Aherë bëj kështu si të them unë: Bëj banja deti me kujdes dhe banja dielli, po ashtu me kujdes, dhe të shohësh që do të të bëjnë fajde, — dhe qeshi.

Që ditën e nesërme, bëra një orë diell e banja deti. E ndjeva veten më mirë. Më të pasnesërmen, 2 orë shëtitje në diell e në det. Akoma më mirë. Kështu arrita të bëja gjer 4 orë shëtitje, dmth banja dielli dhe deti. Arrita të bëja gjithsej, për një muaj, 100 orë shëtitje në diell dhe banja deti. Në peshë rashë 5 kilogram. Vetën e ndieja shumë mirë.

Kjo punë vazhdoi çdo vit. Në krahasim me të kaluarën, edhe pse iknin vitet, veten e ndieja shumë mirë. Pothuajse shpëtova nga reumatizma. Kur ia thashë shokut Enver, ai qeshte dhe më mbuloi me shakara.

Familja ime ndodhej me pushime në plazhin e Durrësit, në një ndërtesë pranë asaj ku pushonte shoku Enver. Nisem edhe unë për në plazh dhe në drekë, vashat e djalit, Gjylfanjon 10 vjeçe dhe Ermelinën 8 vjeçe, nuk i gjeta në shtëpi. Më thotë Katusa se vashat i kishte marrë shoku Enver për drekë.

Pas pak, vijnë ato, shumë shumë të gëzuara, kush të më thoshte më parë fjalët e ngrohta që u kishin thënë shoku Enver e shoqja Nexhmije.

— Po nuk ju erdhi turp nga shoku Enver? — i pyeta.

Ato thanë:

— Po nuk na linte xhaxhi Enveri të

kishim turp. Na thoshte: «Po gjyshi, a ju do shumë?». Ne i thamë «e kemi babi, jo gjysh». Xhaxhi Enveri qeshte e na pyeste për gjithçka.

Një ditë poqa shokun Enver, e nderrova dhe u ula. Më pyeti për mbesat, futi dorën në xhep e nxori një zarf me fotografitë ku kishte dalë me to. Më porositi t'jua jepja nga ana e tij.

Ua dhashë e ato me gëzim të patreguar, më pyetën:

— Babi. t'i dërgojmë dhe babi Felekut në fshat një nga këto, se xhaxhi Enveri na ka dërguar shumë?

— Mirë, ia dërgoni, — u thashë.

— Po vallë a do xhaxhi Enveri, që të dalin tutje fotografitë? — pyeti papritur Ermelina.

— Këtë s'e di unë, nuk marr përgjegjësi, — u thashë.

— Atëherë dhe ne nuk e dërgojmë, — vendosën të voglat.

Bëra çudi me to. «Kanë ngrënë bukë me shokun Enver», mendova.

Në Kuç festohej 30-vjetori i themelimit të organizatës së Partisë të Kurveleshit. Në mbrëmjen e asaj dite shkova në shtëpinë e Partisë. Kur më pa aty shoku Enver më pyeti:

— Pse nuk ke shkuar në Kuç, në ceremoninë e 30-vjetorit të organizatës së Kurveleshit? Ti je pjesëtar i saj!

— U bëra letër, shoku Enver, nuk shkova se kishim mbledhjen e Presidiumit.

— Lëri ato, — më tha. Po të doje, ti merrje leje nga shokët e niseshe. Gjetkë e ke hallin...

Heshti pak, pastaj me buzë në gaz ngriti zërin:

— More, mos të ka ardhur keq ngaqë

në gazetë shkruhej «organizata e Kuçit», e jo «organizata e Kurveleshit e formuar në Kuç»?! Me siguri, këtu do ta kesh pasur hallin që nuk ke vajtur!

Desha s'desha, e pranova hapur, se më zbuloi të vërtetën.

— Ti, — vazhdoi ai me ton të qetë, — ishe nga shokët kryesorë të asaj organizate, ndaj duhej të veje dhe, bashkë me fjalët e mira, t'u bëje vërejtje atyre shokëve atje, për t'i përcaktuar gjërat mirë...

Ç'vërejtje me vend!

Viti 1972, qershor. Shoku Enver vjen për ditëlindjen time. Më uron, pastaj fillon të më pyesë për Kurveleshin, si shkojnë, si janë me punë etj. Pastaj më thotë:

— Po Feleku, si është tani, a u shërua plotësisht?

U çudita se si e kishte marrë vesh që Feleku kishte qenë sëmurë! I them:

— Është mirë, shoku Enver, ka ardhur, e kam matanë.

— Ku është, — më tha menjëherë, — foli të vijë, ta pjek... ! Dhe u poq me të, e pyeti me shumë përzemërsi, për veten e tij, për popullin, se si shkojnë punët atje, si janë shokët e rrethit, si punojnë, a u vijnë ndonjëherë, a i zgjidhin hallet

e popullit, a i dëgjon populli... Pastaj e pyeti për shtëpinë e Asim Zenelit, a është bërë shtëpi-muze.

Unë dëgjoja, por nuk çuditesha se e kisha të qartë kujdesin e shokut Enver, për t'i hyrë në hollësi çdo gjëje.

Në gazetën «Pararoja» të Gjirokastrës shoku Enver kishte lexuar një artikull të gazetarit Avdulla Kënaçi. Flitej për mbjelljen e ullinjve me origjinë nga Berati në shegat e Picarit. Qe një artikull shumë kritik e me vend. Shoku Enver vjen për mbledhjen e Presidiumit, dhe duke varur pallton në garderobë, më pyeti:

— Shefqet, e këndove artikullin e «Pararojës» që picarjotë u ngopnë me ullinj! — dhe po qeshte.

— E lexova, — i thashë.

— Ama mirë ua bën ai gazetari, i kritikon drejt! Si mund të bëhen ullinjtë në shegat e Picarit! Apo mos janë të Hume-licës? — më tha përsëri duke qeshur.

— Tani janë të përbashkëta, shoku Enver. S'ka më Picar e Humelicë.

— Ashtu vërtet, — tha ai. — Ajo gazeta «Pararoja» ka shokë që shkruajnë mirë. Pashë edhe një shkrim për kalldrëmet e Gjirokastrës. Bukur.

Pastaj u hodh në gazetën e Dibrës e në të tjera, duke cituar shkrime të ndr_ - shme. Mendoja: qysh ua del së lexuari të gjitha gazetave!

Ishim në ditëlindjen e shokut Enver, tetor 1972. Do të dilnim në fotografi. Doja që shoqen Nexhmije ta vinim në mes, por ajo nuk pranonte, donte të rrija unë mes shokut Enver e asaj.

Shoku Enver ndërhyri e na shqiti:

— Nexhmija e ka hak, ty të takon në mes!

— Kemi thënë: emancipimi! — kundërshtova me humor.

— Po, po, — tha shoku Enver, — po këtu jemi në shtëpinë e saj, ju jeni mysafir. Pastaj edhe mosha e kërkon vendin.

Me këtë humor dolëm në fotografi.

Ishim në Pallatin e Brigadave për mbrëmjen e Vitit të Ri. Unë ika rreth një orë para shokëve, se më dhimbte koka, kurse shoqja ime, Katua, qëndroi me shoqet. I thashë shoferit që, më pas, të shkonte atje e ta merrte kur të dilnin. Ashtu bëri. Në ora 2. 50 shoferi, nëpër gjumë, e përpyek makinën për peme dhe Katua plagoset. E morën shokët, e shpunë në klinikë, më lajmëruan edhe mua.

E dëgjoji ngjarjen shoku Enver e më pyeti në telefon për shëndetin e saj. Pastaj më këshilloi ta shohin mjekët më të mirë etj. Ishin mbledhur në shtëpi shumë shokë fshatarë, që kishin ardhur për Vitin e Ri dhe u çuditën për kujdesin e shokut

Enver edhe për gjëra të tilla. Ndërkaq shoku Enver më thoshte se pse mbaja të tillë shofer.

— Është i mirë, shoku Enver, po iu prishën frenat — i thashë.

— Ashtu thoni ti e Spiro Koleka, — shtoi ai, — i mbroni, por kini kujdes me të tillë shoferë.

Një i afërt i Katos, Neshet Lluka, tha:

— Dhe sikur të vdesë Katua, unë që e kam kushurirë të parë, nuk dëshpërohem tani, kur shoh se vetë udhëheqësi i Partisë e i popullit kujdeset për të e flet në telefon. Ai të rrojë sa malet!

Vija nga Skrapari. Isha në inaugurimin e lapidarit të Qafa e Gjarpërit. Kthehem në Tiranë drejt e në zyrë, pa vajtur në shtëpi. Shoku Enver, duket, më pa nga zyra e tij dhe i thotë sekretarit të tij të më thërriste.

— Më zutë ngushtë shoku Enver, — i thashë në telefon, — S'jam rruar e pastruar; të vij më vonë...

— Ashtu siç je hajde! — më tha dhe shkova. Kur u futa ashtu brenda në zyrën e tij, sigurisht i kërkova të falur. Ai qeshi. Filloi të më pyeste për gjendjen e Skraparit. Kishte përpara një letër të shkruar. që unë nuk e shihja. Më pyeste për tokat e reja, për rendimentin. për sa-

sinë e tokës nën ujë, për hektarët, e kë-
shtu me radhë. Unë i përgjigjesha, ai
tundte kokën. Më në fund më tha:

— Mirë e ke njohur gjendjen. Pas-
nesër do të shkoj vetë në Skrapar.

I thashë:

— Shoku Enver, rruga nuk është aq
e mirë nga Poliçani në Çorovodë.

— Ashtu siç është, unë do të vete!
— më tha. Dhe vajti.

Gusht i vitit 1973. Bashkë me shokun Adil Çarçani, mbasi u kthyem nga festa e batalioneve «Asim Zeneli» e «Baba Abaz» dhe nga takimi që pata me zgjedhësit në Kurvelesh, ramë dakord t'i bënim një vizitë shokut Enver, i cili ishte me pushime në malin e Dajtit. Ishte pasdite, ora 16.00, kur arritëm pranë vilës ku qëndronte ai. Takuam grupin e oficerëve, midis të cilëve Sulo Gradecin. E pyetëm nëse ishte ngritur shoku Enver nga gjumi apo jo. Na tha se duhet të jetë ngritur dhe na propozoi të shkonim brenda. Në këtë kohë shoku Enver ishte ngritur dhe kishte dalë në ballkon bashkë me shoqen Nexhmije. Shikonte me dylbi.

Na priti me përzemërsi të madhe, me përqafime. Na pyeti se si shkuan festat,

si ishte gjendja e popullit, entuziazmi, gjer veshja e tyre e ushqimet, punët në kooperativë e kështu me radhë. Mua, meqë kisha pasur edhe takim me zgjedhësit, më pyeti veçanërisht se si janë kurveleshasit, si e kanë gjendjen ekonomike, a është përmirësuar akoma më mirë, si qe bujqësia. blegtoria etj. Veçanërisht në mënyrë të posaçme më pyeti për rezervuarin e Gusmarit, i cili ishte bërë me porosi të tij. Më pyeti edhe për ca gjëra të tjera të vogla, si zakonisht.

Ne mundoheshim t'i përgjigjeshim për të gjitha, por ai e shikonte se ne në disa raste nuk përgjigjeshim dot, dhe na ndihmonte duke i plotësuar vetë.

Shoqja Nexhmije nuk lejoi që të na servirin punonjësit, por u ngrit vetë dhe na ofroi fruta të ndryshme, siç bëjnë gratë e vendit.

Kaluam mbi një orë e gjysmë në atë thjeshtësi dhe përzemërsi të madhe. Vendosëm të ikim, megjithëse na thanë që të rrinim për darkë. Ne kërkua prapë leje, që të na linin të largoheshim.

Kur u ngritëm, u bëmë gati që t'u linim shëndetin, por shoku Enver me shoqen Nexhmije nuk pranuan, na përcollën gjer poshtë. Iu lutëm që të mos dilnin përjashta, mbasi frynte erë. Ata prapë nuk

pranuan. Na shoqëruan deri te makina, e cila ishte mjaft larg.

Shoku Enver, ashtu sipas zakonit të tij, me gaz e humor, na thotë:

— Si nuk bëmë një fotografi! — dhe në çast e thirri Sulon. — Na bëj ca fotografi, megjithëqë është mbrëmje dhe mund të mos dalim dhe aq mirë, — i tha.

Bëmë shumë fotografi, duke ndenjurr e duke ecur.

Shoku Enver gjen kohë e i thotë në ecje shokut Adil:

— Nga data 5 shtator është mirë të kemi një informacion mbi planin, mbi gjendjen në përgjithësi, se do të bëhet mbledhja e Byrosë Politike. Prandaj përgatite ti, shoku Adil, se dhe unë, në fund të muajit do të kthehem.

Shkuam afër makinës për të hipur, por as shokut Enver me shoqen Nexhmije dhe as neve nuk na bëhej që të ndaheshim nga njëri-tjetri. Qëndruam para makinës, biseduam prapë për shumë probleme shtetërore e shoqërore.

Edhe mbasi hipëm në makinë, shoku Enver me shoqen Nexhmije nuk lëviznin nga vendi. U nisëm, duke i nderuar me dorën lart me dashuri të thellë emocionale. Po na vinte shumë rëndë ngaqë ata po qëndronin aty akoma.

15 shkurt 1973. Jemi në mbledhje të Presidiumit. Mbasi mbaruam pikën e parë, bëmë 15 minuta pushim. Shoku Enver më pyeti se si shkoi festa e 30-vjetorit të çlirimit të Libohovës, ku unë kisha qenë i deleguar. Pastaj pyeti a është vënë dorë në Libohovë, a janë kryer ato porosi që lamë 2-3 vjet më parë kur ishim atje, a është hapur laboratorit e të tjera.

U mundova që t'i thosha se pjesërisht janë bërë dhe pjesërisht jo, por shoku Enver i dinte më mirë nga unë, edhe pse nuk ishte vetë aty këtë herë. Filloi të fliste se si duhet punuar e si duhen parë gjërat me syrin kritik.

Pastaj biseda kaloi në shkrime, për

librat e romanet tona, se si ato duhet të jenë reale e të bukura dhe si shembull solli romanin e Ismail Kadaresë «Kronikë në gur».

— Ky roman përshkruan realitetin me vërtetësi e forcë, ashtu siç ka qenë në kohët e para, — tha mes të tjerash shoku Enver dhe vazhdoi: — S'kanë të drejtë disa gjirokastritë që zemërohen me disa të vërteta që përshkruhen në libër, sepse ashtu ka qenë realiteti gjirokastrit. Kishte, krahas mendimeve, zakoneve e traditave më të mira, edhe magjira, me çudira e me sokakë të marrësh. — Heshti pak dhe vazhdoi: — Mbaj mend një gjirokastrit se si u betua mbi njeriun e tij të vrarë me hasmëri. E pashë vetë se më dërgoi aneja të merrja ujë me gjym. Xhandarët s'na linin, po ku pyesnim ne. Gjirokastriti, i afërt i të vرارit, erdhi ngadalë, i qetë e hijerëndë, hedhur gunën krahëve me xhamadan puthitur. Nxori koburen, e trokiti në dhogën e tabutit ku qe i dhembshuri brenda, dhe tha: «Betohem se do të vras dy për hakun tënd... » Dhe dy vrau. Kështu qenë kohët dhe njerëzit. Ismaili i ka bërë një përshkrim shumë të bukur e realist qytetit, botës së tij. Edhe përkthimi në frëngjisht është shumë i mirë.

Pastaj duke qeshur iu drejtua Rrapo Dervishit:

— Shefqeti kur zbriti nga Libohova u kthye në Gjirokastër, apo shkoi anës, se ky e ka mendjen në Tepelenë! Tepelena është zbukuruar mirë, — vazhdoi shoku Enver, — do të bëhet dhe shtëpia e pritjes në mal atje sipër, po mos vijnë ujtit, — tha prapë me humor. Unë i thashë:

— Vajta në mbledhjen e këshillit popullor në Gjirokastër shoku Enver, megjithëqë unë jam nga Tepelena.

Ai qeshi e pastaj pyeti me hollësi edhe për kalanë e Gjirokastrës. Më tha:

— E ke marrë përsipër edhe ti qëtë rregullohet, prandaj mos harro, duhet që kalaja të vihet në rregull, të bëhen mermetime, të pastrohen bodrumet, të merren masa që të mos pikojë kalaja, të zbulohen bodrumet e bincat që ka poshtë e që nuk janë zbuluar akoma se regjimet e mëparëshme e kanë shkatërruar në mënyrë barbare. Ata s'vunë dorë kurrë për ta mirëmbajtur, vetëm për të prishur e shkatërruar muret interesoheshin.

20 dhjetor 1973. U njoftova të merrja certifikatën e votimit nga lagjja se më datën 23, ora 10, unë dhe shoku Pilo Peristeri do të shkonim të votonim bashkë me shokun Enver. Gëzimi ishte i madh. Ashtu u bë. Më datën 23 shkuam në vilën numur 4, ku banonte përkohësisht shoku Enver. Futemi brenda, na presin shoqja Nexhmije dhe motra e shokut Enver, Sanoja. Shoqja Nexhmije, si gjithnië, me mirëpritje. me buzë në gaz. Mbas pak pamë një lëvizje të shqetësuar mjekësh. u turbulluam, por s'e bëmë veten dhe qëndruam në sallon. Vjen shoqja Nexhmije e shoqëruar nga një mjek e na thotë:

— Shoku Enver do të takohet me ju, por ju lutemi, mos vononi, se pati ca shqetësime!

Neve na ra pika. Vamë. Shoku Enver, sado që ishte pa qejf, si zakonisht na përqafoi buzëgas e me dashuri. Nuk e mbaja dot veten dhe u ngrita të shkoja.

— Dale dhe një çikë, mos dëgjoni doktorët, ashtu e kanë! — më tha shoku Enver. Mirëpo ne që e pamë se ishte dobësuar, u ngritëm e u larguam pa e hapur dot gojën. Shkuan ca ditë kur më lajmëruan se bashkë me shokët Haxhi Lleshi e Babë Myslimin do të shkonim se na kërkonte shoku Enver! Fluturova nga gëzimi e mezi prisja çastin ta shihja. Këtë herë, ndryshe nga radha e shkuar, e gjetëm shokun Enver më mirë. Na priti me përziemërsi, na pyeti për punët, shëndetin etj. Iu drejtua Babë Myslimit:

— Ruaj shëndetin, — i tha, — dhe shtëpinë ndërroje, merr një tjetër më të përshtatshme. Duhet të jetosh sa më shumë.

— Të rroni Ju sa malet shoku Enver, pa unë rrojta shumë, — i tha Baba.

— Jo, jo, — vazhdoi shoku Enver, — jeta është e dhembshur njësoj për të gjithë!

Mbas bisedës dolëm në fotografi dhe,

kur u përshëndetëm, unë meqë isha i fundit, u përqafova fort me të dhe prapë u emocionova.

— Je vërtet më mirë? — i thashë dhe m'u lagën sytë.

— Jam shumë mirë, e keqja kaloi! — më tha dhe më përqafoi përsëri.

Kur zbritëm shkallët, shoqja Nexhmije më tha:

— Enverit i mbeti merak ditën e votimit se të pa që u preke shumë.

— Kyç e liga për Enver Hoxhën! — i thashë dhe hipëm në makinë.

Ajo ditë ishte më e vështira dhe më e mërzitura për mua, sepse pashë shokun Enver të sëmurë e të dobësuar. Vonë mora vesh se ishte infarkt i miokardit. Ai vetë s'na foli kurrë për të dhe kurrë s'e bëri veten.

Për Vitin e Ri 1985 shkuam te shoku Enver. Përveç shokëve të Byrosë Politike, ishin edhe Hakiu, Spiroja* dhe unë. Shoku Enver na priti me përzemërsi të madhe, siç e kishte zakon.

— Na i gjallëro një çikë këta shokët,
— më tha.

— Si t'i gjallëroj, shoku Enver, — iu përgjigja unë, — këta nuk e pinë rakinë.

— Po mirë, pi ti Shefqet, — më shpoi ai me të qeshur.

Duke ngritur gotën thashë:

— Partia jonë është e fortë, sokoleshë, 40 vjet armiqtë nuk i bënë gjë, ata

*) Shokët Haki Toska e Spiro Koleka.

i zhdukëm dhe Shqipëria me Ju në krye
është bërë më e fortë dhe më e bukur se
kurrë. Ju paçim sa malet!

Me rastin e 75-vjetorit të ditëlindjes, i shkuam shokut Enver në shtëpi për ta uruar. Ishte i gëzuar. Fjalët e para që na tha ishin:

— E ndiej veten si 50 vjeç, të ri e të gjallëruar.

— Kështu, të ri ju paçim kurdoherë, shoku Enver, — i thamë ne, — të na rroni sa malet për të mirën e popullit, të Partisë e të atdheut!

Fjala solli fjalën e u përmend s'di se si edhe Picari. Shoku Enver tha:

— Pse të mos ishte ky fshat sipër, ku ka klimë të mirë e duket si ballkon. Të parët nuk kanë gabuar që e kanë ndër-tuar Picarin atje sipër.

Pastaj. kur na përcolli, tha:

— Kur do të vemi edhe një herë në Picar, t'i shohim përsëri ato rrepe e të rrimë nën hijen e tyre, se më ka marrë malli?

Një mbrëmje, në shtëpinë e Partisë muhabeti i tij ishte për rritjen e mirëqenies së popullit, si të ishte sa më e bukur jetesa e popullit. Për këtë ai mendonte vazhdimisht. E shqetësonte çështja e tufëzimit. Më pyeti edhe mua një herë për këtë problem:

— Si e priti Labëria tufëzimin?

— E ka pritur mirë, — iu përgjigja.

— Por fshatari e pret mirë tufëzimin kur i shpie qumështin, po e le pa qumësht nuk e pret mirë, — ma ktheu ai.

E përse nuk pyeste shoku Enver? Për të gjitha. Kujdesej vazhdimisht për gjendjen e kooperativave, për furnizimin e tyre, që fshati të mos dallohej nga qyteti,

të kishte telefonin, televizorin, rrugët etj.
si të qytetit.

— Brenda në kalanë e Tepelenës, —
më tha një herë tjetër, — nuk duhen lënë
njerëz të banojnë.

Shoku Enver donte që edhe kjo kala
: të ishte si ajo e Gjirokastrës.

Vitet e fundit Komiteti Kombëtar i Veteranëve mori një godinë të mirë, me shumë dhoma, me një sallë për mbledhje etj., të pajisura me komoditetet e nevojshme.

Mblidhen aty çdo ditë shokë të Luftës, bisedojnë e punojnë, mbledhin e diskutojnë edhe kujtime... Punën e kemi organizuar mirë, kemi ngritur gjashtë seksione që lidhen edhe me komitetet e veteranëve në rrethe.

Me porosi të shokut Enver ngritëm një kartotekë që e pasurojmë gjithnjë. Për çdo dëshmor kemi dosje.

Për tërë këto, merito i përket Partisë, shokut Enver, që na mësoi, na dha guxim,

na inkurajoi. Për ne mbetet të punojmë edhe më shumë që këtë përvojë të pasur t'ua lëmë brezave.

Partia jonë e lavdishme, me shokun Ramiz Alia në krye vazhdon të kujdeset për ta çuar gjithnjë përpara edhe veprën e organizatës luftarake e militante të veteranëve sipas mësimëve të ndritura të shokut Enver Hoxha.

Elegji për Komandantin

Ç'QE KJO PRANVERË

*Ç'qe kjo pranverë, shkoi pa lezet
Ajo që nuk pritej, ja u bë sivjet
Na iku Enveri, na iku përjctë
Ç'bëre moj natyrë këtë kiamet!*

RE TË ZEZA

*Duallnë re të zeza, lajmëruan botën
Na vdiq Enver Hoxha, që ndriti epokën
Bëri mrekullira në një vend të vogël
Një fanar ndriçues, e mbrojti marksizmin
Mu në Kremlin brenda, dënoi Nikitën
I tha «tradhëtore, errësore dritën
Devijove rrugën ti me gjithë klikën
Bashkimin e humbe, i prure të ligën
Na s'jemi me ty, nuk ta kemi frikën!»*

TI JE GJALLË

*Nuk harrohe brez pas brezi e në shekuj
Ti je gjallë Enver xhani, nuk ke vdekur,
Pranë popullit në çdo zemër Ti ke mbetur
Ti je gjallë Enver xhani, nuk ke vdekur.
Vjen Ramizi na hedh dorën përmbi supe
Kokën lart! — na thotë trimi, me të bëjmë tutje!*

SHUMË RËNDË JAM PLAGOSUR

*Mu në zemër jam plagosur
Jam i gjallë e s'më mban toka
Ç'bëre o Enver Epoka!*

PSE S'MË PUNON DORA...

*Unë zakon s'e kisha që të bëja be
Vdekur e pa kallur, ç'ke moj zemër ç'ke!
Unë jeshe mësuar të veje atje,
Ruzëgaz më flisje: «O Shefqet si je?
Kur do vemi prapë te rrepet në Gurrë?!
Nuk më del nga mendja, nuk e harroj kurrë
Atë vend të bukur, burronjat me ujë».
Më thoshte Enveri. Si të duroj unë!*

NJË MUAJ

*Po mbushet një muaj që s'të kemi parë
O Enver i dashur na këpute xhanë,
Të mëdhenj, të vegjël në mendje të kanë
Mbarë Shqipëria vjen të shohë varrë
Të të puthë baltën aty ku ke rarël!*

MOJ

*Moj kështjella kryelartë
O Gjirokastra në pllakë
Moj kështjella mbi kështjella
Linde dragua me vlera
Ashtu si pushka dhe pena*

MBROJTI ME GUXIM STALINË

*Gjithë bota u habinë
Në Kremlin mbrojte Stalinë
Renegatët u çudinë
Ku e gjen, vailë, guximnë!
Nuk e njihnin historinë
Enveri ca më mirë
Mbrojti me guxim Lirinë
Demaskoi tradhtinë!*

VEPRA JOTE DO TE RROJE

*Këmba këmbës do të ndjekim
Veprën tënde nuk e prekim
Do ta mbajmë tërë jetën.
Me ty në mendje, në gojë
Vepra jote do të rrojë
Në shekuj do përparojë
Mu si çesmë do burojë*

SIVJET S'LULËZOJNË

*Bilbilat, thëllëzat sot nuk po këndojnë
Mbajnë dhe ato zi, dhe ato kërkojnë
Zërin e Enverit që nuk e dëgjojnë
Të buçasë zëri që të gjallërojnë.*

JEHONË E MADHE

*Enver Hoxha në epokë
I dolli Shqipes për zot
Si Skënderbeu i fortë
Shqiptarët kudo janë
Zemrën me të e kanë
Shqipërisë i vuri famë.*

*Enveri zemër dragua
Trimëri e mëndje krua
Në tërë botën u dëgjua.*

TË QAU

*Të qau Shqipëria si nëna evlanë
Si motra vëllanë që i digjet zemra,
Përkulen të gjithë kur vijnë te varri
Komandant o dritë, do na djegë malli,
Po na le Partinë, Ramizin në krye,
Si lis plak ndej krahët, shkoj me hapn e tyre.*

MËSIMET I KEMI

*Do bëjmë durim, do ta ngremë lart
Emrin e tij në zemër, në gjak,
S'ndryshojmë as çikë në vijën e saktë
Mësimet i kemi, çdo gjë është e qartë.*

O ENVER

As ke vdekur, as vdes kurrë *o Enver*
Vepra jote ndezur nur *o Enver*
Nuk le asnjeri në gjumë *o Enver*
As të varfër pa kulturë *o Enver*
Dhe në male shpure ujë *o Enver*
Në çdo fshat drita dhe punë *o Enver*
Të kulloi djersa gurrë *o Enver*
Sa rrove s'pushove kurrë *o Enver*
Çkrive veten si qiriri *o Enver*
Ndrite porsì xhevahiri *o Enver*
Atdheu me Tyj rilindi *o Enver*
Shqipërinë e bëre nur *o Enver*
Vepra jote nuk vdes kurrë *o Enver*

PËRMBAJTJA

Dy fjalë lexuesit.....	3
Kujtime.....	7
Elegji për Komandantin	209